 ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bankieri

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Nr. 11 Prill 2014

ISSN 2225-2959



9 772225 295004



















BUJQËSIA
Sfida e radhës



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



ANËTARËT E AAB

 ALPHA BANK	 <small>BANKA KOMBETARE TREGTARE</small>	 CREDINS bank	 CRÉDIT AGRICOLE
 <small>CREDIT BANK OF ALBANIA BANJA E KREDITIT TE SHQIPTARE</small>	 Fibank <small>First Investment Bank</small>	 <small>Banka Nderkombetare Tregtare International Commercial Bank</small>	 INTESA SANPAOLO BANK <small>Albania</small>
 NBG Bank	 ProCredit Bank	 Raiffeisen BANK	 SOCIETE GENERALE ALBANIA
 TIRANA BANK	 UNION BANK	 UBA <small>United Bank e Shqiptare Banka e Bashkuar e Shqiptare</small>	 VENETO BANKA <small>GRUPPO VENETO BANCA</small>

■ www.aab.al

Përmbajtja

EDITORIAL

BUJQËSIA – Sfida e radhës
nga Elvin MEKA

f.5

TEMA E DITËS

Huaja për bujqësinë – çështje dhe mundësi për bankat
nga Adela LEKA

f.6

Kreditimi i Bujqësisë, si një instrument zhvillimi, rritjeje
dhe formalizimi nga Edmond PANARITI

f.9

KËNDI I GAZETARIT

BUJQËSIA - shumë vështirësi por dhe nevojë për një
moment të ri huadhënie nga Besart KADIA

f.11

INTERVISTA

Banka Ndërkombëtare Tregtare – banka e afërt me
klientin - Intervistë me Gideon VAN DER BROEK

f.13

SISTEMI BANKAR

Përfitimet & Fleksibiliteti, pikat kyçe të rritjes së
qendrueshme nga Alberto PRESTOPINO

f.14

Përmirësimi teknologjik në raportimin statistikor –
fjalëkalimi i kohëve moderne nga Diana SHTYLLA
dhe Sonila TAÇI

f.17

Bankat europiane në pritje nga Roberto RUOZI

f.19

Financimi i ndërmjetëm – një mundësi për shlyerjen
e detyrimeve të qeverisë ndaj biznesit nga Altin HOTI
dhe Elvin MEKA

f.21

FORUMI I EKSPERTËVE

Kontributet për pensione private – një (mos)përrjashtim
tatimor! nga Teuta BALETA dhe Rinald GURI

f.25

KËNDI I EKONOMISTIT

Abenomics si “politika e tre shigjetave” - debate dhe
dyshime për efikasitetin e saj nga Adrian CIVICI

f.27

PËRGJEGJSHMËRIA SOCIALE

Veprimtaritë e bankave

f.31

RRJETI BALLKANIK

Lajme ndërballkanike

f.35

TEKNOLOGJI

20 Vjet SWIFT në Shqipëri – 20 vjet partneritet
nga Najada XHAXHA

f.39

AAB

Veprimtaritë e Shoqatës Shqiptare të Bankave

f.42



BANKIERI është publikimi zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. BANKIERI i jep lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arritjet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave tregtare në veçanti.

Bankieri

Nr. 11, Prill 2014

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Redaksia:

Elvin Meka

Kryeredaktor

Eftali Peçi

Koordinatorë Produksioni

Junida Tafaj (Katroshti)

Bashkëpunëtorë

Andis Rado

Fotograf

Design & Layout: Ladybird Creations

Shtypi: Gent-grafik

Bordi Editorial:

Seyhan PENCABLIGIL

Kryetar i AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i

Banka Kombëtare Tregtare

Ioannis KOUGIONAS

Nënkryetar i AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i

NBG Bank Shqipëri

Christian CANACARIS

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i

Raiffeisen Bank Shqipëri

Periklis DROUGKAS

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i

Alpha Bank Shqipëri

Frédéric BLANC

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i

Societe Generale Shqipëri

Bozhidar TODOROV

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i

Fibank Shqipëri

Endrita XHAFERAJ

Sekretare e Përgjithshme, Shoqata Shqiptare e Bankave

Hysen ÇELA

Kryetar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Adrian CIVICI

President & Drejtor i Shkollës Doktorale

Universiteti Europian i Tiranës

Spiro BRUMBULLI

Drejtor i Kabinetit të Ministrisë të Financave

Enkeleda SHEHI

Kryetare e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bulevardi: “Dëshmorët e Kombit”, KULLAT BINJAKE

Kulla I, Kati 6-të, A3, Tiranë

Tel: +355 4 2280 371; Fax: +355 4 2280 359

E-mail: bankieri@aab-al.org; www.aab.al

Biznesi: D&T Archi_plan Studio

Punonjësit: 4

Fitimi mujor: 84.500 Lekë

Orë pune: 12 orë/ditë

Përkushtimi: PA FUND



Në mbështetje të biznesit të vogël!

Financim, produkte dhe çmime konkurruese, shërbim i dedikuar.



NBG Bank
Tradicionalisht e besueshme



nga Dr. Elvin MEKA¹
Kryeredaktor

BUJQËSIA – SFIDA E RADHËS

Bujqësia nuk është biznes si gjithë të tjerët, por në dallim nga të tjerët ndihmon fuqishëm për sigurimin e një zhvillimi të qendrueshëm ekonomik. Kjo e bën bujqësinë të veçantë dhe tepër strategjike brenda ekonomisë kombëtare dhe mbështetja për të nga bankat e tejkalon kuadrin thjesht të një portofoli huash dhe përfitimesh monetare.

“Puna në fermë duket shumë e thjeshtë kur plugu yt është lapsi dhe kur je njëmijë milje larg fushës me misër!”. Kjo thënie e famshme e z. Duait Ajzenauer, Presidentit të 34-ërt të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shpjegon më së miri kompleksitetin që shoqëron financimin e bujqësisë dhe të agrobiznesit në përgjithësi. Ajo duket shumë reale dhe e mirënjohur, nëse vendoset në kontekstin e realitetit të bujqësisë dhe sektorit financiar në Shqipëri.

Përgjatë gjithë rrugëtimit të saj, bujqësia shqiptare ka përjetuar një paradoks thujse endemik, pasi është mëse i dukshëm fakti i një mospërputhje të theksuar midis rolit dhe peshës që zë bujqësia në prodhimin e brendshëm bruto dhe financimit të saj nga sektori financiar dhe skemat publike të financimit. Ndërkohë që shërben si veprimtari bazë për thujse gjysmën e popullsisë së vendit që banon në zonat rurale, ajo kontribuon me rreth 20 përqind në PBB, por ka arritur deri më sot të tërheqë financime nga sistemi financiar, më pak se 2% të totalit të tepricës së huas. Por ky paradoks nuk është problemi më i madh, pasi në mënyrë të pabesueshme ai është plotësisht i justifikuar. Kjo, sepse penetrimi i shërbimeve bankare në bujqësi mbetet ende sfidë, kryesisht si pasojë e kostove të larta të financimit, problemeve themelore që lidhen me mungesën e kolateralit standard për garantimin e huave, informalitetit, mungesës së informacionit, bashkëpunimit mes fermerëve, segmentimit të theksuar të fermës bujqësore, mungesës së ekonomisë së shkallës dhe prirjes për zbatimin e modeleve të njëjta të produkteve bankare nga bankat, si në zonat urbane ashtu dhe në ato rurale.

Për sistemin bankar shqiptar është tashmë e qartë se, nisur nga kuadri aktual i gjendjes që kalon ekonomia dhe efekteve të zgjata të krizës së

fundit ekonomike dhe financiare globale, si dhe maturimit të disa sektorëve të ekonomisë, një nga të paktat drejtime ku identifikohen përfitime afatgjata, pavarësisht kostove dhe rreziqeve, është pikërisht bujqësia dhe agrobiznesi. Sigurisht, kjo përbën më shumë se një sfidë për bankat, pasi para tyre shtrihen një sërë kërkesash që lidhen me: modelimin më të mirë të produkteve e shërbimeve financiare rurale, sipas nevojave dhe realiteteve praktike apo specifike të fermerëve dhe prodhimit bujqësor, informimin dhe edukimin e fermerëve për produktet, shërbimet, mekanizmat financiarë dhe këshillimet e specializuara për çështjet rurale që ato ofrojnë, natyrisht duke siguruar një nivel të lartë transparence për to.

Ka ardhur koha tashmë që bankat ta vlerësojnë dhe trajtojnë kreditin bujqësor përtej praktikës së përfitimeve afatshkurtra, që nuk merr në konsideratë rrjedhojat afatgjata të përmbushjes së tyre. Praktikisht është imperativ ndërveprimi i bankave me institucione të tjera publike e private, në terma të sigurimit të perspektivës së një zhvillimi të qëndrueshëm, sipas modeleve të reja të zhvillimit të biznesit bujqësor. Kjo, pasi bujqësia nuk është biznes si gjithë të tjerët, por në dallim nga të tjerët ndihmon fuqishëm për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik. Kjo e bën bujqësinë të veçantë dhe tepër strategjike brenda ekonomisë kombëtare dhe mbështetja për të nga bankat e tejkalon kuadrin thjesht të një portofoli huash dhe përfitimesh monetare, pasi siç pohonte dikur Presidenti i parë i SHBA-së, z. Xhorxh Uashington: *“Unë nuk di të ketë shërbim më të mirë dhe më të prekshëm që mund t’i bëhet një vendi, sesa përpjekja për të përmirësuar bujqësinë e tij, mbarështuar racën e kafshëve të dobishme për të, si dhe të degëve të tjera të bujqësisë!”*

¹ Përgjegjës i Departamentit të Financës, UET



nga Zj. Adela LEKA
Anëtare e Drejtorisë Ekzekutive,
PROCREDIT BANK

HUAJA PËR BUJQËSINË – ÇËSHTJE DHE MUNDËSI PËR BANKAT

Për vetë tipologjinë e produktit përfundimtar të këtij sektori, sipërmarrësit kanë nevojë për investime të vazhdueshme në teknologjitë e përmirësimit të procesit të prodhimit, në proceset e vaditjes, në pajisje eficiente si dhe rritjen e kapaciteteve përpunuese e grumbulluese të prodhimit.

Sektori i agrobiznesit, për vetë specifikën që ka për ekonominë shqiptare, po merr gjithnjë e më shumë një rol të rëndësishëm. Disa organizma ndërkombëtare si: GIZ, USAID, BERZH etj, kanë mbështetur rritjen dhe zhvillimin e këtij sektori, në përputhje me strategjitë kombëtare/qeveritare, duke ndërmarrë disa projekte të ndryshme për agrobiznesin shqiptar. Pavarësisht kontributit në ekonominë shqiptare dhe prirjes pozitive në rritjen e eksporteve bujqësore, ky sektor vazhdon të ketë akses të ulët në shërbimet financiare të sistemit bankar, megjithë interesimin dhe fokusin gjithnjë në rritje për këtë sektor.

Për vetë tipologjinë e produktit përfundimtar të këtij sektori, sipërmarrësit kanë nevojë për investime të vazhdueshme në teknologjitë e përmirësimit të procesit të prodhimit, në proceset e vaditjes, në pajisje eficiente si dhe rritjen e kapaciteteve përpunuese e grumbulluese të prodhimit. Duke realizuar këto investime dhe duke përkrahur teknologjitë e reja, prodhimet vendase do të kenë mundësinë të bëhen më konkurruese në tregun ndërkombëtar.

Sfidat dhe vështirësitë me të cilat përballlet sektori i agrobiznesit

Këto sfida dhe problematika janë të shumta. Së pari, sektori i agrobiznesit mbetet ndër sektorët me rrezik të lar-

Bizneset bujqësore duhet të optimizojnë proceset e prodhimit, përpunimit dhe grumbullimit të lëndës së parë, duke investuar në teknologji eficiente, me konsum të ulët karburanti/energji elektrike dhe rendiment të lartë. Për më tepër, në përputhje edhe me ciklin e prodhimit, agrobiznesi ka nevojë për kapital qarkullues, për të menaxhuar më mirë fluksin e punës dhe të qarkullimit të parasë për biznesin.

të. Për shkak të veçorive të prodhimit të këtij sektori si dhe mungesës së një infrastrukture të mirëpërcaktuar në total, agrobiznesi është tejet i ndjeshëm ndaj kushteve natyrore/atmosferike (kryesisht përmbytjet, ngricat dhe shirat që shkaktojnë dëmtime në masë të prodhimit). Ky lloj rreziku është shpesh i vështirë për t'u vlerësuar plotësisht nga institucionet financiare. Për më tepër, ky rrezik shoqërohet edhe nga mungesa e skemave të siguracioneve, lidhur me

ndjeshmërinë ndaj kushteve natyrore. Prania e këtyre skemave do të ndikonte pozitivisht në shmangien apo zvogëlimin e këtij rreziku dhe do të inkurajonin sistemin bankar të tregohen më shumë sipërmarrës në lidhje për sektorin e bujqësisë dhe agrobiznesit në përgjithësi.

Së dyti, bizneset bujqësore shpesh kanë mangësi në dokumentacion, në njohuri financiare dhe manaxheriale, që e bën këtë sektor të ketë vështirësi për t'u kredituar nga sistemi bankar. Kjo "përkthehet" në një rrezik më të lartë për institucionet financiare, që kërkojnë më shumë qëndrueshmëri, si nga ana e informacionin financiar dhe ecurisë së biznesit, ashtu edhe në planet e investimit ku do të përdoret financimi.

Së treti, një sfidë shumë e madhe mbetet marrëdhënia me pronësinë e tokës. Përveç faktit që agrobiznesi shqiptar operon në ngastra toke me madhësi mesatare 1.2 hektarë (nën mesataren europiane), ka edhe probleme të tjera. Madhësia e kufizuar sjell pamundësinë e shfrytëzimit të përparësive të ekonomisë së shkallës, që do të rriste prodhimin, duke zvogëluar kostot për njësi për biznesin. Gjithashtu, një problematikë tjetër e pronësisë, parë nga këndvështrimi i institucioneve financiare, është garancia për shërbimin e kërkuar financiar. Shpesh pamundësia për të mos mbuluar dot

kërkesat për garanci detyron bizneset që të mos kryejnë investime për zhvillimin e tyre.

Mundësitë e sektorit të agrobiznesit për zhvillim dhe sistemi bankar

Pavarësisht kontributit të madh që ka ky sektor në ekonominë vendase, financimi nga sistemi bankar është ende në nivele shumë të ulta. Gjithëse, vlen të përmendet rritja, gjatë viteve të fundit, e fokusit drejt këtij sektori. Pavarësisht sfidave me të cilat përballen, sektori ka mundësi të mëdha për zhvillim. Kështu, bizneset bujqësore duhet të optimizojnë proceset e prodhimit, përpunimit dhe grumbullimit të lëndës së parë, duke investuar në teknologji eficiente, me konsum të ulët karburanti/energji elektrike dhe rendiment të lartë. Për më tepër, në përputhje edhe me ciklin e prodhimit, agrobiznesi ka nevojë për kapital qarkullues, për të menaxhuar më mirë fluksin e punës dhe të qarkullimit të parasë për biznesin. Rritja e investimeve në këtë sektor orientohet nga rritja e kërkesës në treg për produkte bujqësore dhe blegtorale, por jo vetëm. Prirja pozitive në kërkesën për eksport të produkteve vendase, të cilat konkurrojnë me seriozitet në tregjet europiane, është një tregues shumë pozitiv dhe inkurajues për agrobizneset dhe ekonominë shqiptare në përgjithësi.

ProCredit Bank, një partner i rëndësishëm për agrobiznesin shqiptar

ProCredit Bank është një bankë e orientuar drejt zhvillimit dhe si e tillë i ka kushtuar një rëndësi të veçantë

agrobiznesit. Që prej vitit 2000, ProCredit Bank ka ofruar shërbime të përgjegjshme financiare, për të siguruar një rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm për bizneset bujqësore – më shumë se 30,000 hua të dhëna dhe më shumë se 95 milionë euro, të disbursuara përgjatë këtyre viteve.

Rëndësia dhe përkushtimi që Banka ProCredit i ka dhënë këtij sektori, është pasqyruar gjithashtu edhe në krijimin dhe përshtatjen e strukturave të brendshme të përkushtuara ndaj agrobiznesit, me ekspertë të fushës. Sot ProCredit Bank ka një portofol aktiv huaje mbi 25 milionë euro dhe më shumë se 4,500 klientë, duke pozicionuar veten si një partner i besueshëm për agrobiznesin.

Duke patur një eksperiencë të madhe në këtë sektor si dhe punonjës të specializuar për agrobiznesin, ProCredit Bank ka sjellë vazhdimisht shërbime të përgjegjshme financiare, për të përmbushur nevojat e klientëve të vetë. Njohja shumë mirë e tipologjisë së biznesit, identifikimi i flukseve të të ardhurave dhe vlerësimet e sakta të sezoneve të prodhimit, u japin këshilluesve tanë të biznesit sigurinë që t'u ofrojnë klientëve sugjerime dhe asistencë teknike, përpara se të marrin një vendim financiar, në mënyrë që investimi i kryer të rrisë përfitueshmërinë e biznesit. Banka ofron mbështetje për bizneset që hapen për herë të parë (huat Start-Up), për të mbështetur të gjithë ata klientë të ndërmarrin nisma për të krijuar një fermë, apo që duan të investojnë në pronat e tyre, duke

mbështetur kështu edhe fermerët që kthehen nga emigracioni dhe dëshirojnë të investojnë në Shqipëri.

Huaja ProAlternative ofron kushte lehtësuese në kërkesën për kolateral për të gjithë ato biznese të konsoliduara që përballen me vështirësitë e pronësisë. Këshilluesit e agrobiznesit bazohen në informacionin dhe analizën e plotë financiare të biznesit, qëndrueshmërinë dhe planin e mirëpërcaktuar të investimit dhe kjo siguri u jep mundësinë e financimit me kushte shumë lehtësuese për kolateral. ProCredit Bank ruan standarde të larta të përgjegjshmërisë bankare, duke e bazuar kredihënien të kapacitetin e kthyeshmërisë së kredisë, dhe jo mbi kërkesat e mbulimit me garanci.

Trekëndëshi i Bashkëpunimit dhe Zhvillimit është një projekt ambicioz, i cili vazhdon prej dy vjetësh në bankën tonë. Nëpërmjet këtij projekti, ProCredit synon të përmirësojë funksionimin e të gjitha pjesëve të përfshira me më shumë eficiencë dhe shkallë të lartë fitimi, duke patur mekanizmat e duhur për një zinxhir funksional agrobiznesi, si dhe për një ekuilibër më të mirë të kërkesë-ofertës.

Si pjesë e grupit ProCredit me qendër në Frankfurt, e cila shtrihet në 21 shtete, ne ofrojmë mundësinë e lidhjes së rrjetit të klientëve dhe mundësinë e gjetjes së tregjeve të reja për klientët tanë, duke konfirmuar angazhimin si një partner i qëndrueshëm dhe i besueshëm financiar për bizneset dhe agrobizneset.





Banka partnere e biznesit



**KREDI BIZNESI
ME KUSHTE
TË FAVORSHME**

Kredi që plotëson nevojat e biznesit tuaj:

- ✓ Me interesa më të ulta
- ✓ Kushte lehtësuese për kolateral
- ✓ Me afate deri në 84 muaj



Ky financim përfitohet nga garancia e lëshuar nën fondin "Faciliteti për Zhvillimin dhe Inovacionin e Sipërmarrjeve në Ballkanin Perëndimor", financuar nga **Bashkimi Europian**.

KREDITIMI I BUJQËSISË, SI NJË INSTRUMENT ZHVILLIMI, RITJEJE DHE FORMALIZIMI



nga **Prof. Dr. Edmond PANARITI**
Ministër i Bujqësisë, Zhvillimit Rural
dhe Administrimit të Ujrave

Kreditimi është një mënyrë obliguese dhe impenjative e financimit të bujqësisë dhe si i tillë përbën një instrument të fortë zhvillimi dhe rritjeje, e me efekte më të mëdha në krahasim me grantin.

Në rrethanat e vështira të ekonomisë dhe të financave të vendit, bujqësia vazhdon të rritet edhe pse ende shumë nën mundësitë e saj. Nëse do t'u referohemi statistikave të tremujorit të fundit të vitit që shkoi, ajo ende rritet me rreth 2.9 për qind. Një vështrim i financave në fushën e bujqësisë, zbulon se këto kryesisht përbëhen nga fonde të buxhetit të shtetit, pjesa dërrmuese e të cilave alokohen për financimin e skemave kombëtare të mbështetjes së prodhimit bujqësor dhe blegtoral. Këtë vit, këto fonde të livruara kryesisht në trajtën e pagesave të drejtpërdrejta në mbështetje të fermerëve, shënuan një rritje prej 60 për qind, në krahasim me një vit më parë.

Megjithatë, bujqësia mbetet e nën-financuar, në raport me kontributin e saj në prodhimin e brendshëm bruto të vendit. Një pjesë e rëndësishme e financimeve të bujqësisë injektohen edhe si pjesë e programeve IPA të Bashkimit Europian, nëpërmjet instrumenteve të paraanëtarësimit, siç është edhe programi IPARD-like, i paraparë si një program "stërvitor" parapërgatitor për fermerët dhe agrobizneset, për të rritur aftësitë dhe plotësuar kriteret për të përfutur nga

skemat financuese më rigorozë të programit IPA.

Por në thelb, ajo që i mungon ndjeshëm bujqësisë shqiptare, është pikërisht kreditimi. Kreditimi është një mënyrë obliguese dhe impenjative e financimit të bujqësisë dhe si i tillë përbën një instrument të fortë zhvillimi dhe rritjeje, e me efekte më

Përballë tkurrjes së sektorëve tradicionale të zhvillimit ekonomik të vendit si: ndërtimi, sektori i shërbimeve si dhe prirja në rritje për t'iu drejtuar prodhimit bujqësor dhe agropërpunimit, si një alternativë më e qendrueshme dhe afatgjatë për zhvillimin e vendit, ka bërë që sistemi bankar shqiptar, i cili karakterizohet përgjithësisht nga likuiditeti i tepërt, të shohë seriozisht rritjen e ndjeshme portofolit të huadhënies për bujqësinë.

të mëdha në krahasim me grantin. Megjithatë, bujqësia vazhdon të mbetet sektori më pak i kredituar i ekonomisë kombëtare, duke përfutur rreth 2 për qind të totalit të të gjithë portofolit të huave që i janë akorduar ekonomisë kombëtare. Shkak për këtë kanë qenë deri tani shkalla e lartë e informalitetit të bujqësisë, mungesa e certifikatave të pronësisë mbi tokën, fakt që pamundëson huamarrësit për të siguruar kolateral si garanci për huan, njëkohësisht edhe mungesa e skemave të sigurimit të prodhimit, nga feramat dhe fermerët. Sidoqoftë, përballë tkurrjes së sektorëve tradicionale të zhvillimit ekonomik të vendit si: ndërtimi, sektori i shërbimeve si dhe prirja në rritje për t'iu drejtuar prodhimit bujqësor dhe agropërpunimit, si një alternativë më e qendrueshme dhe afatgjatë për zhvillimin e vendit, ka bërë që sistemi bankar shqiptar, i cili karakterizohet përgjithësisht nga likuiditeti i tepërt, të shohë seriozisht rritjen e ndjeshme portofolit të huadhënies për bujqësinë. Kjo është padyshim shumë inkurajuese. Ajo që ende kërkohet të instalohet është fryma e munguar financiare e besimit dhe e sigurisë, nëpërmjet fondeve

apo aktiveve të garancisë, ku qeveria shqiptare dhe posaçërisht Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave kanë një rol të pazëvendësueshëm qendror e katalizues në këtë drejtim, sidomos për gjetjen dhe ngurtësimin e këtyre fondeve.

Nga ana tjetër, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave po përparon

me kurajo drejt shpërndarjes së certifikatave të pronësisë për fermerët, duke liruar në këtë mënyrë një ngërc në marrëdhëniet midis sistemit banke dhe vetë atyre. Ndër të tjera, për herë të parë Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave do të fillojë instalimin e skemave të sigurimit të pronave dhe të prodhimeve bujqësore dhe këtë do ta bëjë nëpërmjet një projekti ambicioz,

si pjesë e një programi të financuar nga një hua e butë italiane. Po kështu, përmbyllja e disa marrëveshjeve për investime të huaja të drejtpërdrejta në fushën e bujqësisë kërkon mobilizimin e shpejtë të kreditimit bujqësor, për të filluar zbatimin. Personalisht jam optimist se riaktivizimi i kreditimit të bujqësisë do të jetë i shpejtë dhe një nxitës shumë i madh i prodhimit bujqësor në vend.

PËRMIRËSIMI I FINANCIMIT PËR SEKTORIN E AGRO-PËRPUNIMIT



RisiAlbania (www.risialbania.al) është një projekt novator që kërkon të përmirësojë konkurrueshmërinë dhe rritjen në sektorët e Agro-përpunimit, Turizmit dhe ICT në Shqipëri. Si pjesë e mandatit, RisiAlbania zhvilloi së fundmi me ekspertë një studim të thelluar mbi mundësitë dhe kufizimet në financimin e sektorit të agro-përpunimit. Studimi, i mbështetur në nevojat aktuale të agropërpunuesve, synon të japë informacion për zhvillimin e shërbimeve financiare të përshtatura.

Studimi konfirmoi potencialin për rritje të lartë të agro-përpunimit dhe theksoi se aftësia paguese e sektorit është shumë më e lartë sesa perceptohet aktualisht nga bankat.

Gjetjet kryesore janë:

- Një performancë shumë e mirë portofolit të kredive krahasuar me industrinë e tjera, me një përqindje mesatare të kredive me probleme prej 6% (ndërsa përqindja mesatare kombëtare është 25%), dhe, parvarësisht perceptimeve, një sektor me rrezik të ulët dhe potencial të lartë.
- Agro-përpunimi është një segment tregu më i formalizuar dhe më pak i ndikuar nga sezonaliteti se bujqësia me të cilën asociohet rregullisht.
- Agro-përpunimi ka patur një rritje të qëndrueshme graduale prej 3.3% në 5 vitet e fundit, që pritet të vazhdojë.
- Kreditimi i agro-përpunimit vështirësohet nga produkte financiare të papërshtatura, procedura aplikimi komplekse e të gjata, dhe një vlerësim risku i neefikas dhe i anshëm.
- Bankat kanë njohuri të kufizuara mbi sektorin e agro-përpunimit.

Për institucionet financiare, kjo do të thotë që ka një potencial të fortë rritje nëse ato:

- Zhvillojnë produkte kredie të përshtatura për sezonalitetin e cdo nënsektori të agro-përpunimit.
- Shpejtojnë procedurat e aplikimit.
- Përmirësojnë procedurat e vlerësimit të riskut dhe kredisë.
- Përmirësojnë njohuritë teknike dhe ekspertizën e oficerëve të kredisë mbi agro-përpunimin.

RisiAlbania është e angazhuar të përmirësojë mundësitë e agro-përpunuesve për financim dhe po nis ndërhyrje dhe kërkon partnerë mes institucioneve financiare për të bashkëpunuar me qëllim zhvillimin e zgjidhjeve dhe shfrytëzimin e potencialit të sektorit të agro-përpunimit. Partnerët financiarë të interesuar në këtë iniciativë inkurajohen të kontaktojnë RisiAlbania tek: ashehaj@risialbania.al dhe të vizitojnë www.risialbania.al.

BUJQËSIA - SHUMË VËSHTIRËSI POR DHE NEVOJË PËR NJË MOMENT TË RI HUADHËNIE

Mungesa e theksuar e kolateralit është një ndër arsyet kryesore që ky sektor nuk është tërheqës për bankat e në kushtet kur shumë fermerë zhvillojnë veprimtarinë e tyre në parcela me sipërfaqe mesatare 1.2 hektarë, ku titujt e pronësisë janë ende të paqartë e ku aktivi kryesor në këtë industri mbetet toka, bëhet i kuptueshëm hezitimi kaq i gjatë i bankave për të rritur huadhënien për këtë sektor.

nga Z. Besart KADIA

Një ndër statistikën më të përmendura nga gazetarët, ekonomistët apo politikanët shqiptarë është mospërputhja mes numrit të madh të të punësuarëve në sektorin bujqësor dhe kontributit që ajo sjell në Prodhimin e Brendshëm Bruto. Kështu, sektori i bujqësisë punëson rreth gjysmën e gjithë të punësuarëve në vend dhe kontribuon afërsisht me 20% të PBB-së. Ndërkohë, ky sektor në Shqipëri është aktualisht pjesa më e pazhvilluar e ekonomisë shqiptare dhe vuan nga fragmentimi i thellë i sipërfaqes së tokës së punueshme dhe pas një harrese të gjatë, qeveria vendosi subvencionimin e fermerëve, të cilët mbjellin ullinj, agrume, drufrutorë dhe vreshta, vetëm në vitin 2010. Kjo masë është e domosdoshme, pasi vetëm në këtë mënyrë bujqësia shqiptare mund të arrijë të konkurrojë me sektorin bujqësor të vendeve fqinjë. Që nga kjo kohë, eksportet bujqësore kanë njohur rritje të vazhdueshme, duke u bërë edhe më inkurajuese nga fakti se eksportet drejt vendeve të BE-së janë rritur. Por nga ana tjetër, ky sektor njihet dhe për statistika të tjera, po aq shqetësuese, sa përmendëm pak më sipër. Për shembull: sektori bankar shqiptar gjatë vitit që shkoi kishte në total 547 miliard lekë hua, prej të cilës sektori i bujqësisë përfitoi vetëm 1.8% të totalit, krahasuar me ndërtimin prej 13.4% apo industrinë përpunuese rreth 16.4%.

Mungesa e theksuar e kolateralit është një ndër arsyet kryesore që ky sektor nuk është tërheqës për ban-

kat. Në kushtet kur shumë fermerë zhvillojnë veprimtarinë e tyre në parcela me sipërfaqe mesatare 1.2 hektarë, ku titujt e pronësisë janë ende të paqartë e ku aktivi kryesor në këtë industri mbetet toka, bëhet i kuptueshëm hezitimi kaq i gjatë i bankave për të rritur huadhënien për këtë sektor. Sipas një studimi të kryer nga ekonomistët Imami dhe Zhllima, mungesa e sigurisë mbi pronësinë e tokës ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin e sektorit. Në mbi 700 fermerë të pyetur, më shumë se 20% e tyre ndihen të pasigurt, përse i përket pronësisë që kanë mbi tokën e tyre. Në këtë vërtetim të kryer në mbi 15 fshatra në Shqipëri, vihet re gjithashtu se vetëm 57% e të intervistuarve kishin kryer investime për të rritur produktivitetin në tokën e tyre gjatë pesë viteve të fundit dhe 70% e investimeve totale ishin kryer në toka, pronësia e të cilave perceptohej si e sigurt nga ana e fermerëve. Sipas këtij studimi, investimet ishin më të sigurta dhe konfliktet sociale më të vogla në ato toka ku pronarët mund të tregonin se toka ishte në pronësi të familjes së tyre para vitit 1945.

Gjithashtu, duhen patur parasysh ndryshimet demografike në vend dhe ndryshimet në forcat e punës. Sipas Census 2011 dhe 2001, popullsia në zonat rurale është reduktuar ndjeshëm gjatë 10 viteve të fundit me afro 280 mijë banorë dhe në këto shtatë vitet e fundit me afro 195 mijë banorë, reduktim që, i kombinuar me rritjen e rendimentit të punës në bujqësi

ka sjellë natyrshëm edhe reduktimin e forcës së punës në bujqësi, që është zhvendosur drejt qyteteve dhe punësimit urban. Por ky sektor i ekonomisë nuk mund të zhvillohet njëjloj në gjithë qarqet e vendit; p.sh.: qarku me të ardhurat më të larta vjetore nga prodhimi bujqësor rezulton Fieri, që siguron rreth 14.9 miliardë lek nga fermat, ku 43% e të ardhurave vjen nga prodhimi bujqësor dhe 57% nga prodhimi blegtoral. Ndërkohë, qarku me të ardhurat më të ulta nga bujqësia është Kukësi, që siguron rreth 2 miliardë lek në vit.

Nga ana tjetër, ky sektor mund të përfitojë nga subvencionimi që mund të marrë nga fondet e BE-së, si p.sh.: Ipar-d-like. Ky i fundit është një fond i BE-së, në mbështetje të bujqësisë për vendet që aderojnë të jenë pjesë e BE-së. Ky program ofron 8.2 milionë euro në mbështetje në dy masa kryesore: fermerët dhe agropërpunuesit. Të gjithë personat që dëshirojnë të ngrenë një fermë, apo të merren me agropërpunimin, do të financohen në masën 50-65% nga ky grant, por ajo që është kusht për këtë grant është përpilimi i një plan-biznesi të besueshëm dhe thirrja e fundit e bërë në vitin 2012 tregoi pikërisht dhe një dobësi tjetër të këtij sektori, pasi numri i përfituesëve ishte më i vogël nga sa parashikohej. Gjithsesi, kthimi i vemendjes drejt bujqësisë është i pashmangshëm dhe i domosdoshëm, për zhvillimin e ekonomisë shqiptare.

 **Raiffeisen BANK**

10 VJET NË SHQIPËRI



**Raiffeisen
BANK**

BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE – BANKA E AFËRT ME KLIENTIN



Z. Gideon VAN DER BROEK,
Drejtor i Përgjithshëm,
Banka Ndërkombëtare Tregtare, ICB

BANKIERI:

NË OPINIONIN TUAJ, CILI ËSHTË ROLI QË MUND TË LUAJË DHE SA HAPËSIRA KA NJË BANKË E VOGËL, BRENDA SISTEMIT BANKAR SHQIPTAR?

Së pari, do të dëshiroja që të tipizoja ICB-Albania më shumë si një bankë butik, sesa si një bankë e vogël, për më tepër besojmë se një treg si Shqipëria ka potencial të mjaftueshëm për të gjitha llojet e bankave. Nga eksperiencat e mia të mëparshme me institucione të mëdha financiare, jam trajnuar mjaftueshëm për të përmbushur objektivin e një banke, sipas kërkesave të klientit. Pasi iu bashkova ICB-Albania-s mund të pohoj me besim, se kjo është banka e parë që e ka arritur këtë objektiv. Si pjesë e tregut bankar shqiptar që prej vitit 1997, ICB-Albania ka grumbulluar mjaft njohuri rreth këtij tregu dhe është plotësisht e aftë të përfitojë prej tyre, në drejtim të menaxhimit të përditshëm të veprimtarisë bankare. Nga fundi i vitit 2011 banka ka hapur një faqe të re, duke transformuar mënyrën e organizimit. Modelimi sipas interesave të klientëve përbën fillin e kuq që përshkon të gjithë organizimin e veprimtarisë sonë dhe eksperiencat e klientëve tanë ndërveprojnë në çdo aspekt me veprimtarinë e bankës. Ky është një tipar unik i bankës, prej të cilës mund të përfitojë gjatë shumë viteve në vijim.

BANKIERI:

CILI ELEMENT APO TIPAR DO TË IDENTIFIKONTE MË SË MIRI NË TREGUN SHQIPTAR BANKËN NDËRKOMBËTARE TREGTARE?

Në vijim logjik të pyetjes së parë dhe në kuadër të vlerës së modelimit të bankës sipas kërkesave të klientëve, unë besoj se elementin kritik e përbën cilësia e shërbimit, e kjo është arsyeja pse kemi shpenzuar kohë dhe përpjekje për

Afrimiteti me klientët përbën fillin e kuq që përshkon të gjithë organizimin e veprimtarisë sonë dhe eksperiencat e klientëve tanë ndërveprojnë në çdo aspekt me veprimtarinë e bankës.

përmirësimin e nivelit të shërbimit. Përveç kësaj, madhësia e bankës na mundëson të veprojmë me shkathësi, e për këtë arsye, përmirësimet mund të jetësohen shpejt dhe me efikasitet.

BANKIERI:

SI DO TA VLERËSONIT VITIN 2013 PËR VEPRIMTARINË E BANKËS SUAJ?

Gjatë vitit 2013 ICB-Albania vijoi të përqëndrohet në përmirësimin e aftësive të saj; nga portofoli i produkteve e deri te kompetenca e stafit. Ne jemi krenarë për produktet e reja që kemi paraqitur në segmentin e Individëve dhe Biznesit të Vogël, një segment ky me rëndësi strategjike. Nëse duhet të përmend një produkt të veçantë, do t'i referohesha produktit tonë të ri të huas hipotekore, ku i është kushtuar vëmendje fleksibilitetit të tij. Meqenëse ky produkt përfshin një angazhim afatgjatë të konsumatorit me bankën, e vlerësuam si shumë të rëndësishme të shtonim karakteristika të cilat ndjekin tipikisht ciklin e jetës të klientëve të këtyre huave. Kështu, huaja përfshin një pauzë të pagesës së kësteve për familjet që presin një fëmijë (paguhet vetëm interesi për 12 muaj), si dhe mundëson pagesa të përshpejtuara - sipas evolucionit natyral të karrierës së individit. Duke ndjekur prirjet e fundit, në median sociale, ICB-Albania ka tërhequr më shumë se 10,000 fans në Facebook. Gjithashtu, është intensifikuar veprimtaria e marketingut nëpërmjet bashkëpunimit me programin "100 milionë", në Top Channel. Përpunimi i transaksioneve është përmirësuar; tashmë transaksionet kryhen me sekonda e jo me minuta. Klientët tanë me anë të një SMS-je mund të kontrollojnë gjendjen e llogarisë së tyre, si dhe të kërkojnë një nxjerrje elektronike të saj.

BANKIERI :

CILI MENDOHET TË JETË PRIORITETI DHE OBJEKTIVI KRYESOR I BANKËS PËR VITET E ARDHSHEME?

Si për çdo biznes, rritja është prioriteti ynë kryesor. Ne besojmë se ICB-Albania ka një rol të rëndësishëm për të luajtur në Shqipëri, jo vetëm për përgjegjësinë që ka si një partner aktiv financiar për individët dhe bizneset, por edhe për mënyrën se si operon. Në mungesë të potencialit të lojtarëve më të mëdhenj në treg, ICB-Albania duhet të jetë tepër e shkathët, për të përfaquar ndryshimet në ekosistemin financiar. Ne kemi hartuar një plan të ri 5-vjeçar, ku fokusi - përveç objektivave tradicionale bankare - është gjithashtu mbi zbatimin e teknologjisë së re, me objektivin për të prodhur sa më shumë eksperiencë pozitive për klientët dhe zgjidhjet më të mira bankare.

PËRFITIMET & FLEKSIBILITETI, PIKAT KYÇE TË RRRITJES SË QENDRUESHME



nga Z. Alberto PRESTOPINO,
Drejtor

*Divizioni i shërbimeve & produkteve
bankare për individët
INTESA SANPAOLO BANK*

Ekonomia shqiptare shfaqti shenja të qarta ngadalësimi përgjatë vitit 2013. Kërkesa e jashtme dhe stimuli fiskal ishin nxitësit kryesorë të zhvillimit ekonomik, ndërkohë që investimet private dhe konsumi pësu-an tkurrje. Konsumatorët gjatë vitit 2013 shfaqën hezitim për të shpenzuar, duke zgjedhur të kursenin.

Prirja e klientëve për të kursyer sigurisht që nuk kaloi pa u vënë re nga bankat tregtare. Fokusi i bankës sonë u përqëndrua më shumë në shfrytëzimin e tipareve të veçanta të depozitave, të cilat do të mund të tërhiqnin vemendjen e klientëve. Banka, për të "kapur" këtë prirje të klienteve për kursim, si dhe për të diversifikuar portofolin e përgjithshëm të depozitave, filloi që nga viti 2012 të vendoste theksin te depozitat me afat më të gjatë (deri në 2-3 vjet), duke u ofruar klientëve përveçse një game më të gjerë produktesh, edhe një bazë të sigurt normash interesi të qendrueshme, për një kohë të përcaktuar. Fokusi dhe përpjekjet tona u përqëndruan jo vetëm në krijimin e një produkti tërheqës nga pikepamja e normës së interesit dhe tipareve për

Masat e Bankës së Shqipërisë dhe qeverisë shqiptare, si dhe fokusi dhe modelimi i duhur i produkteve nga ana e bankave, mund të jenë vendimtare në tejkalimin e dobësisë aktuale ekonomike, duke çuar kësisoj drejt një rritje të qendrueshme ekonomike.

këto lloj produktesh më afatgjata (si për shembull pagimi i interesit çdo 6 muaj), por edhe në marketimin e duhur të produktit. Vlen të përmendet që këto përpjekje kishin vlerë, pasi numrat po vijnë në rritje dhe klientët po bëhen më të gatshëm për të investuar në depozita me afat më të gjatë se 1 vit.

Strategjia e bankës sonë për të transferuar pjesërisht depozitat e klientëve në afate maturimi 2 dhe 3 vjeçare, pa dyshim ka kontribuar në ofrimin e një shansi real tek individët, për të kufizuar prirjen rënëse të normave të interesit për depozitat, e cila që nga fundi i vitit 2012 ka qenë një ngjarje pothuajse e zakonshme në treg. Ndërkohë që prirja rënëse e madhësisë së depozitave në monedhën vendase, është nxitur kryesisht nga prirja gjithnjë në rënie e yield-it të letrave me vlerë të qeverisë shqiptare, si dhe nga ulja e vazhdueshme e normës bazë të interesit, si një nga instrumentet e rëndësishëm që përdor dhe shfrytëzon Banka e Shqipërisë për transmetimin e politikës monetare.

Politika monetare që po ndiqet nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet uljes së normës bazë të interesit, është një qasje globale e politikës monetare, e cila pritet të zgjasë në kohë. Duke qenë një politikë lehtësuese, ajo ka kontribuar në rënie të yield-it të letrave me vlerë të qeverisë shqiptare, që nga ana tjetër ka ndikuar në uljen e kostos së financimit nga klientët në treg. Ulja e kostos së financimit mundëson që sistemi bankar t'u japë hua individëve dhe jointindividëve me norma më të ulëta interesi. Një

fakti i tillë u vu re, si gjatë vitit që shkoi ashtu edhe gjatë këtij viti, si dhe është e dallueshme nga ofertat mjaft konkurruese që bëjnë bankat, jo vetëm në monedhën vendase, por edhe në monedha të huaja. Përsa i përket huadhënies, në përputhje edhe me sugjerimet dhe rekomandimet e Bankës së Shqipërisë, përpjekjet më të mëdha të kryera nga banka vitin që kaloi ishin të drejtuara drejt kanalizimit të procesit të huadhënies në Lek, duke pasur veçanërisht si synim uljen e rreziqeve të lidhura me kursin e këmbimit. Megjithatë, kjo nuk është një praktike dhe mënyrë

Edhe pse tregu është zhvilluar ndjeshëm dhe klientët janë më aktivë në investimet me afate më të gjata sesa investimi tradicional 12 mujor, ende ka vend të besohet se është e parakohshme për tregun, në këtë fazë zhvillimi të tij, që një pjesë e mirë e klientëve do të kalojnë drejt investimeve 5, 7 madje dhe 10 vjeçare, pavarësisht normës më të lartë të kthimit.

sjelljeje që ndryshon brenda natës, si domos kur merret parasysh fakti që kërkesa e klientëve për hua në monedhë të huaj diktohet kryesisht nga çmimi i shitjes së monedhës. Këtu nevojitet një fushatë e fuqishme dhe e vazhdueshme edukimi, e kombinuar me aftësi mjaft të mira bindëse nga ana e stafit, në mënyrë që klientët që vijnë në bankë për marrjen e një huaje, të jenë të aftë të marrin një vendim të drejtë. Pavarësisht kësaj, nevojitet kohë si dhe përpjekje të vazhdueshme, për të thelluar edukimin dhe kulturën financiare të masës së gjerë të klientëve dhe joklientëve.

Ulja e normave të interesit për depozitat e klienteve, mund të interpretohet edhe nën dritën e efekteve të mundshme negative, që lidhen me interesimin e shtuar të individëve për të blerë letra me vlerë të qeverisë shqiptare, në tregun parësor dhe dytësor, me yield-e më të larta. Që kjo e fundit të konsiderohet si kërcënim për tregun, duhet të merren parasysh:

- 1) Për individët, sasia e letrave me vlerë e ofruar në treg është e kufizuar, për shkak të shpërndarjes së borxhit qeveritar ndërmjet individëve dhe institucioneve financiare. Nga ana tjetër, në rastin e individëve me kursime të mëdha, pjesëmarrja në ankand duhet të jetë me norma shumë konkurruese, kriter i vështirë ky për t'u plotësuar nga publiku i gjerë, pasi kërkon njohuri mjaft të mira rreth tregut. Për më tepër, edhe pse tregu është zhvilluar ndjeshëm dhe klientët janë më aktivë në investimet me afate më të gjata sesa investimi tradicional 12 mujor, ende ka vend të besohet se është e parakohshme për tregun, në këtë

fazë zhvillimi të tij, që një pjesë e mirë e klientëve do të kalojnë drejt investimeve 5, 7 madje dhe 10 vjeçare, pavarësisht normës më të lartë të kthimit. Kjo vihet re qartësisht edhe nga të dhënat e publikuara nga Banka e Shqipërisë, ku vetëm 3.8% e depozitave kanë kohëzgjatje më të madhe sesa 2 vjet (sipas të dhënave të janarit 2014).

- 2) Skemat e Investimeve Kolektive janë veçanërisht të përshtatshme për klientët që janë të gatshëm të sipërmarrin, së bashku me përfitimet, edhe disa rreziqe dhe luhajtje, që lidhen me ecurinë e këtyre skemave. Gjithsesi, ky nuk është rasti i masës së depozituesve, të cilët kanë më shumë besim të depozitave paratë e tyre kundrejt një norme të përcaktuar interesi.

Duke ju kthyer sektorit të huadhënies, dukshëm vihet re se ishte sektori më i ndikuar nga rënia ekonomike. Rrjedhimisht, huadhënia mbeti e dobët gjatë vitit që kaloi, duke pasqyruar kërkesën e ulët për financim, si dhe theksimin e politikave konservative të huadhënies nga bankat. Megjithatë, huadhënia nuk mbeti jashtë fokusit të bankës sonë dhe u bënë përpjekje të mëdha, me qëllim që ajo të promovojë e të bëjë më e arritshme për klientët. Rritja e ritmit të huave me probleme përgjatë 2013-ës nuk përket detyrimisht në uljen e normave të interesit, pasi kosto e financimit mbetet sërisht në të njëjtin nivel. Intesa Sanpaolo Bank, nën dritën edhe të praktikave më të mira të grupit, ndër morri një sërë veprimtarish dhe ndërhyrjesh, me qëllim rishikimin terësor të procesit të huadhënies, si vijon:

Produkti - Produktet ekzistuese të huas iu nënshtruan një procesi rishikimi dhe u krijuan produkte të reja, duke i vënë një theks të veçantë fleksibilitetit, që i jep mundësinë klientit të zgjedhë skemën që i përshtatet më mirë mundësive të tij.

Çmimi - U rishikuan normat e interesit dhe kushtet, përmes diferencimit preferencial të klienteve pagamarrës.

Promovimi - U modelua dhe filloi një proces fushatash promovionale të fuqishme, të përqendruara më shumë në përfitimet e huas, përsa i përket procesit apo produktit, sesa të çmimi.

Procesi - Kryerja e një analize tërësore e procesit rezultoi në automatizimin e procesit të origjinimit të huas, si dhe shkurtrimin e periudhës së aprovimit, deri në 3 ditë.

Njerëzit - Gjatë vitit të kaluar filloi nga funksionimi platforma e-learning, e cila së bashku me trajnimet tradicionale në klasa, ka për qëllim trajnimin sa më të plotë të stafit, në të gjithë aspektet e produkteve të reja.

Përmbledhtazi, pavarësisht rritjes së ulët ekonomike dhe normave të ulëta të huadhënies përgjatë 2013-ës, pritjet për mirësim gradual i veprimtarisë ekonomike për 2014-ën. Pasiguria dhe hezitimi do të vazhdojnë të mbeten problemet kryesore, që do të pengojnë ekonominë shqiptare, megjithatë ne besojmë se nëpërmjet masave të Bankës së Shqipërisë dhe qeverisë shqiptare, si dhe përmes fokusit dhe modelimit të duhur të produkteve nga ana e bankave, një pjesë e konsiderueshme e këtij problemi do të tejkalohet, duke çuar kësaj drejt një rritjeje të qëndrueshme ekonomike.



KREDI PËR SHTËPI

5.5%
LEK dhe EUR



ZGJIDHENI SHTËPINË ME ZEMËR DHE BANKËN ME MENDJE

EUR - 5.5% FIKS VITIN E PARË. NË VAZHDIM EURIBOR + 4.5%; MIN 5.5%
LEK - BONO THESARI MIN 5.5% PËR VITIN E PARË. NË VAZHDIM BONO THESARI + 2%; MIN 5.5%
KOMISION ADMINISTRIMI: 0.75%.

SE BASHKU FORCOJME SHPIRTIN E SKUADRES



**SOCIETE GENERALE
ALBANIA**

PËRMIRËSIMI TEKNOLOGJIK NË RAPORTIMIN STATISTIKOR – FJALËKALIMI I KOHËVE MODERNE



Zj. Diana SHTYLLA,
Zëvendës drejtore

Departamenti i Stabilitetit Financiar & Statistikave
BANKA E SHQIPËRISË



Zj. Sonila TAÇI,
Përgjegjëse e Sektorit të Statistikave
Monetare dhe Financiare

Raportimi elektronik do të mundësojë automatizimin e hedhjes së të dhënave nga subjektet raportuese dhe Banka e Shqipërisë, përmirësimin e kontrollit dhe shkurtimin e kohës së raportimit e të përpunimit të informacionit, rritjen e vëllimit dhe të cilësisë së të dhënave, por dhe rritjen e mbulimit në numër subjektësh dhe raportimesh.

Çdo banke qendrore i nevojitet një mbështetje e fortë dhe e vazhdueshme me informacion statistikor, për të përmbushur funksionet e saj të përcaktuara në ligj si: hartimi dhe zbatimi i politikës monetare, mbikëqyrja e sistemit bankar, mbështetja e stabilitetit financiar, administrimi i rezervës valutore dhe sigurimi i mirëfunksionimit të sistemeve të pagesave. Ky informacion, për të qenë cilësor dhe i dobishëm, duhet të plotësojë disa kushte, që lidhen me respektimin e afateve të publikimit, zbatimin e metodologjive të standardizuara si edhe procedurave të përshtatshme për shpërndarjen e informacionit të përdoruesit dhe vendimmarrësit e interesuar. Është pikërisht funksioni i prodhimit të informacionit statistikor, që në shumë vende të botës përfshirë Shqipërinë, i jep bankës qendrore një vend të rëndësishëm në sistemin statistikor kombëtar, krahas zyrave statistikore (INSTAT) dhe Ministrisë së Financave apo Zyrës së Thesarit.

Si në çdo drejtim tjetër, edhe në ushtrimin e funksionit të saj statistikor, ose në rolin e saj si agjenci statistikore, banka qendrore duhet t'i përshtatet ndryshimeve të mjedisit të jashtëm, të tilla si: zhvillimet dhe risitë teknologjike, hyrja në treg e instrumenteve dhe institucioneve

të reja financiare, aktet rregullatore apo metodologjitë e reja, e deri te krizat ekonomike dhe financiare. Veçanërisht këto të fundit luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në kërkesat ndaj agjencive statistikore në nivel botëror duke qenë se çdo krizë, pavarësisht përmasave, ndiqet nga një analizë e hollësishme e mangësive

Rritja e kërkesave për raportim statistikor duhet të mbështetet në një platformë raportimi, që duhet të përmbushë si kriterin e përshtatshmërisë ndaj shtimit dhe shpeshtësisë së ndryshimit të kërkesave për raportim, ashtu dhe kriterin e cilësisë dhe lehtësisë në përdorim, për subjektet raportuese dhe vetë agjencinë statistikore.

të statistikave të periudhës së parakrizës.

Njëkohësisht, për vende si Shqipëria drejt integritetit evropian e bën edhe më të ndjeshme nevojën për zhvillimin e statistikave, drejt një niveli sa më pranë kërkesave dhe standardeve të Bashkimit Evropian dhe organizmave përkatëse të tij në këtë fushë. Kështu, duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me institucione kombëtare e ndërkombëtare statistikore, duke konsideruar vëllimin dhe kompleksitetin e detyrimeve afatmesme për raportim statistikor, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e anëtarësimin në BE, Banka e Shqipërisë vlerëson se është koha për një modernizim të të gjithë procesit të raportimit, me synim automatizimin e tij. Dy nga përvojat e spikatura në këtë drejtim, e që Banka e Shqipërisë pati rastin t'i vizitonte nga afër, ishin ato të Bankës së Italisë dhe Bankës së Sllovenisë. Mbështetja nga këto dy banka qendrore u përqendrua në trajtimin e kërkesave kryesore ndaj një platforme automatike raportimi, në përcaktimin e prioritetëve dhe në harmonizimin e kërkesave për raportim nga përdorues të profileve të ndryshme, si p.sh. mbikëqyrja dhe politika monetare.

Pas një pune administrative te-

Në fazën aktuale, sistemi parashikon raportimin e automatizuar vetëm nga subjektet raportuese - banka, por së shpejti ai do të përfshijë edhe institucione të tjera financiare jobanka, të cilat sipas legjislacionit në fuqi duhet të raportojnë pranë Bankës së Shqipërisë.



jet angazhuese dhe kontributit të rëndësishëm të BERZH-it në këtë drejtim, gjatë vitit 2012 u kontaktuan fillimisht firmat konsulente, të përzgjedhura për ndërtimin e një sistemi automatik raportimi, objektivat e të cilit ishin: rritja e eficiencës së raportimit, ulja e ngarkesës së raportimit dhe rritja e cilësisë së statistikave. Projekti mbulon një periudhë dyvjeçare (nëntor 2012 - tetor 2014) dhe realizimi i tij është ndarë në katër faza të veçanta. Në krye të kërkesave të këtij projekti është vendosja e një sistemi dinamik, web-based, që do të mundësojë raportimin online të subjekteve raportuese, në kushte të posaçme sigurie, e që do të realizojë, në të njëjtën kohë, kontrollin automatik të raporteve dhe gjenerimin e pasqyrave statistikore, në nivel subjekti dhe sistemi. Ky raportim elektronik, ose automatik, do të mundësojë shmangien e hedhjes manuale të të dhënave nga subjektet raportuese dhe nga Banka e Shqipërisë, përmirësimin e kontrollit të raporteve, shkurtimin e kohës së raportimit dhe të përpunimit të informacionit, rritjen e vëllimit dhe të cilësisë së të dhënave të raportuara dhe të përpunuara, si edhe rritjen e mbulimit në numër subjektsh dhe raportimesh. Përfitimi kryesor për subjektet raportuese do të jetë shmangia e ra-

portimit të dyfishtë, kontrolli automatik dhe në kohë reale i të dhënave të raportuara, dhe ndjekja shpejt dhe pa kosto e historikut të raporteve pranë Bankës së Shqipërisë.

Aktualisht Banka e Shqipërisë mbledh të dhëna financiare nga bankat dhe subjektet e tjera financiare jobanka, sipas Sistemit Raportues të Unifikuar (SRU), që është një bashkësi formularësh për raportimin e të dhënave financiare, për nevoja të mbikëqyrjes bankare, stabilitetit financiar dhe statistikave monetare si dhe të sektorit të jashtëm të ekonomisë. Në kuadrin e projektit të automatizimit të raportimit statistikor, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një sërë masash për përmirësimin e SRU-së, në përputhje me standardet e reja ndërkombëtare në fushën e statistikave, si dhe me kërkesat e reja rregullatore dhe makroprudenciale të mbikëqyrjes dhe stabilitetit financiar. Për këtë arsye, faza e parë e projektit të automatizimit të raporteve, përfaqësojë një sfidë të dyfishtë për hartuesit e SRU-së dhe përdoruesit e të dhënave. Pas identifikimit të formularëve: a) që do të mbarten nga SRU-ja ekzistuese, b) që do të ndryshohen dhe c) atyre të rinj, u punua intensivisht për të harmonizuar dhe standardizuar formularët dhe pasqyrat, për të kontrolluar treguesit,

emërtimet, formulat e vlefshmërisë dhe ato të gjenerimit të pasqyrave statistikore, për të prezantuar kodifikimet e nomenklaturave ndërkombëtare dhe klasifikimeve kombëtare, për të përkthyer formularët dhe pasqyrat nga gjuha shqipe në atë angleze dhe anasjelltas, si dhe për të plotësuar mungesat e raportimit në letër dhe përpunimit me sistemin ekzistues të gjenerimit të pasqyrave (SARS²). Në përfundim të kësaj faze, u hartua një bashkësi formularësh dhe pasqyrash për versionin e parë (RRS 1.0), që do të hidhej në sistemin e ri.

Gjatë fazës së dytë të projektit u punua për hedhjen e RRS 1.0 në sistemin e ri të raportimit, si edhe për testimin e të gjithë formularëve, treguesve dhe pasqyrave të ndërtuara në sistem. Testimi u realizua me të dhëna reale të raportuara nga subjektet në periudha të mëparshme. Po gjatë kësaj faze u përfundua prokurimi i pajisjeve teknike si: software, hardware dhe licenca të nevojshme për sistemin, si dhe u përfundua përkthimi në gjuhën shqipe i menuve dhe komandave të sistemit për seksionin e portalit (subjektet raportuese), për qendrën e mbikëqyrjes (Banka e Shqipërisë) dhe për skedarët e ndihmës për të dy seksionet e lartpërmendur. Gjatë fazës së tretë u realizua instalimi i infrastrukturës

¹ Ky projekt është mundësuar me kontributin financiar nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim. <http://www.ebrd.com/saf/search.html?type=project&country=Albania>

² SARS - Sistemi i Administrimit të Raporteve Statistikore.

mbështetëse dhe u hodhën në sistem të gjitha të dhënat e nevojshme për daljen 'live'. Përdoruesit e biznesit dhe ata teknikë të Bankës së Shqipërisë u trajnuan dhe certifikuan për përdorimin dhe administrimin e sistemit. Në këtë fazë u krye edhe trajnimi i industrisë bankare, me përfaqësues nga të gjitha bankat e sistemit.

Faza e fundit e projektit, ajo e marrjes në dorëzim të tij, u fokusua në trajnimin teknik dhe certifikimin e specialistëve, që do të punojnë për mirëmbajtjen dhe mbarëvajtjen e sistemit, në vitet në vazhdim. Mbështetur në njohuritë dhe trainimet e marra gjatë fazave të mëparshme, personeli i Bankës së Shqipërisë, me mbështetjen e firmës konsulente do të hartojë, ndërtojë dhe hedhë në sistem versionin tjetër të tij (RRS 2.0). Nisur nga fakti se, dalja 'live' me sistemin e ri do të realizohet gjatë gjysmës së dytë të vitit 2014, së shpejti do të vijohet me ushtrimin pilot, për 3 njësi raportuese (banka tregtare), të cilat kanë shprehur gatishmërinë për të marrë pjesë në këtë veprimtari. Në fazën aktuale, sistemi parashikon raportimin e automatizuar vetëm nga subjektet raportuese - banka, por së shpejti ai do të përfshijë edhe institucione të tjera financiare jobanka, të cilat sipas legjislacionit në fuqi duhet të raportojnë pranë Bankës së Shqipërisë.

Tashmë dihet dhe pranohet gjerësisht se, pa statistika ekonomike dhe financiare cilësore, të besueshme dhe të hartuara sipas standardeve të Acquis Communautaire, bëhet i pamundur vlerësimi i ecurisë dhe suksesit të proceseve integruese në të gjithë sektorët, ose kapitujt e Acquis Communautaire. Parakushtet për të arritur këto standarde të prodhimit dhe raportimit statistikor, për Bankën e Shqipërisë, përkthehen në thellimin e njohurive rregullatore dhe metodologjike, në trainimin intensiv të burimeve njerëzore, si dhe në ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve teknologjike, për mbledhjen, kontrollin, përpunimin dhe publikimin e statistikave të saj. Projekti për automatizimin e raportimeve ofron përfitime madhore për Bankën e Shqipërisë, si agjenci statistikore dhe si autoritet mbikëqyrës për sistemin bankar, si dhe është një hap i rëndësishëm drejt përmbushjes së objektivave të saj. Ai përbën vetëm fillimin e një procesi zhvillimesh në fushën e raportimit dhe prodhimit statistikor.

BANKAT EUROPIANE NË PRITJE



nga **Z. Roberto RUOZI**

Professor emeritus

UNIVERSITÀ BOCCONI DI MILANO

Cilido qoftë rezultati i provave të ardhshme të rezistencës, ai nuk do të jetë përfundimtar, por shpresohet që ai të mund të konfirmojë përshtypjen, sikundër shumë besojnë, se bankat europiane kanë bërë hapa të dukshëm përpara, që nga zhvillimi i provave të mëparshme.

Bankat europiane po presin me Bankth provat e rezistencës, të njoftuara nga Banka Qendrore Europiane (ECB), të cilat do të zhvillohen në qershorin e vitit 2104. Klima e pritjes është mjaft e qetë, edhe pse problemi i mjaftueshmërisë së kapitalit mbetet ende shumë serioz. Politikat e zbatuara për këtë qëllim nga disa banka lënë vend për të shpresuar. Tek e fundit, vlefshmëria e provave të rezistencës në vlerësimin e qendrueshmërisë së bankave europiane është tërësisht relative, në kuptimin që ato mund të kenë vlerë nëse rezultojnë negative, por nuk është e thënë që të kenë vlerë, nëse rezultojnë pozitive. Në fakt, përvoja ka treguar që bankat, të cilat edhe pse e kishin kaluar provën me sukses të plotë, ranë në gjendje paaftësie paqese pak muaj më vonë.

Cilido qoftë rezultati i provave të ardhshme të rezistencës, ai nuk do të jetë përfundimtar, por shpresohet që ai të mund të konfirmojë përshtypjen, sikundër shumë be-

sojnë, se bankat europiane kanë bërë hapa të dukshëm përpara, që nga zhvillimi i provave të mëparshme. Ndër të tjera, kjo do të demonstron nga rifitimi i besimit të investitorëve amerikanë, të cilët prej disa vitesh i kishin braktisur në fatin e tyre bankat europiane dhe që nga muaji qershor i vitit 2013 kanë filluar të investojnë në kapitalin e këtyre bankave. Është e qartë se bankat europiane kanë akoma shumë rrugë për të bërë, si në drejtim të kapitalizimit ashtu edhe në atë të përfitueshmërisë. Sipas një studimi të fundit të Standard and Poor's është arritur ndërkohë një qetësi relative, si në ribalancimin e maturimit të aktiveve dhe pasiveve ashtu edhe në menaxhimin e likuiditetit, i cili sot është më mirë i strukturuar sesa pak kohë më parë.

Temat kryesore të cilat mbeten ende të hapura do të kërkojnë sërish investime të konsiderueshme, që do të kenë të bëjnë, natyrisht në masa të ndryshme, me banka të veçan-

...nuk duhet harruar që sistemi bankar shqiptar është i ndërtuar në pjesën më të madhe të tij nga banka, të cilat janë pjesë e grupeve europiane, pothuajse të gjithë të përfshira në provat e rezistencës së qershorit të ardhshëm. Rrjedhimisht, është e rëndësishme të njihet situata ku ndodhen grupe të tilla, sepse prej tyre do të varet edhe fati i filialeve shqiptare.



ta, duke i bërë përgjithësimet të rrezikshme dhe duke lejuar hapësirë vetëm për konsiderata mesatare të një rëndësie të kufizuar. Fakt është se nuk ka marrëveshje për mënyrën e trajtimit të temave të tilla, për më tepër është e qartë që disa prej tyre mund t'i përshtaten vetëm disa bankave të caktuara.

Një nga temat më të diskutueshme ka të bëjë me objektivin e "madhësisë", që shqetëson mbi të gjitha bankat më të mëdha. Lidhur me këtë thuhet se, disa prej tyre kanë arritur përmasa të rrezikshme, të cilat duhen zvogëluar si me shitjen e linjave të biznesit dhe me përqendrimin e operacioneve në tregje më të ngushta, veçanërisht në ato vendase. Të tjerë besojnë se "madhësia" është një problem i paqenë dhe ajo që ka rëndësi në fakt është kompetenca për të menaxhuar më mirë përmasat, cilado qofshin ato. Në këtë këndvështrim, në kundërshtim me çfarë pohohet në përgjithësi, disa besojnë se përqendrimi i veprimtarisë në tregun vendas është një gabim dhe se do të ishte më e përshtatshme krijimi i bankave ndërkufitare, të cilat nëse menaxhohen mirë, mund të kenë më tepër qëndrueshmëri.

Në mënyrë analogjike, përfundimisht mund të gjykohet në forma të

ndryshme ushtrimi i veprimtarive të shumëllojshme, apo ndarja ndërmjet veprimtarisë tregtare dhe asaj investuese (p.sh. sikundër parashikohet në ligjin e ri bankar Britanik). Në lidhje me këtë të fundit jam i bindur se nuk ka rëndësi zgjedhja e modelit, por thelbësore është cilësia e menaxhimit, çka risjell për diskutim, rolin, kapacitetin dhe etikën e drejtuesve, nga ku do të varen kryesisht fatet e bankave në të ardhmen. Duke marrë të mirëqenë faktin që, aftësia profesionale e menaxherëve, hapësirat kohore të veprimtarisë së tyre, qëndrimi ndaj veprimtarive ekonomike reale përkundrejt atyre financiare, qëndrimi ndaj shpërblimit dhe veçanërisht pjesës variabël të tij, si dhe kapaciteti i drejtimit të burimeve njerëzore, janë të përshtatshme dhe domosdoshmërisht të ndryshme nga ato që karakterizuan menaxherët kur shpërtheu kriza. Ata duhet të ndërtojnë dhe të përhapin një kulturë të re bankare, të domosdoshme për përballimin me skenarët e ndryshuar të tregut.

Në këtë pikë lind pyetja: çfarë interesi mund të ketë Shqipëria për t'u njohur me këto çështje? Përgjigja është e thjeshtë: nga njëra anë, në fakt, njohuria është gjithmonë e dobishme edhe pse objekti i njohurisë duket sikur nuk është i lidhur drejtpërdrejt

me problemet e momentit. Shqipëria në fakt nuk është e integruar në Bashkimin Europian dhe bankat e saj nuk janë objekt i provave të rezistencës së Bankës Qendrore Europiane. Nga ana tjetër, nëse do të shfaqej ndonjë situatë kritike mund të pritej ndonjë vendim radikal për këto filiale, që në raste ekstreme mund të ktheheshin në objekt shitje, me qëllim arkëtimin, lehtësimin e detyrimeve të kapitalit dhe racionalizimin e strukturës së grupeve në fjalë. Përkundrazi, nëse shfaqen situata pozitive, filialet shqiptare mund të ndihen të lehtësuara dhe me shumë gjasa mund të vazhdojnë të zhvillojnë veprimtarinë e tyre pa probleme.

Para se të nxirren konkluzione përfundimtare në këtë drejtim, do të jetë mirë të kujtohet ajo që është thënë në hyrje, pra që provat e rezistencës janë diçka e rëndësishme, por jo vendimtare. Sidoqoftë vetëm këto prova nuk mund të ndryshojnë në mënyrë thelbësore strategjitë e bankave. Sigurisht, mund të jenë sinjale të rëndësishme (pozitive apo negative), të cilat nuk mund të anashkalohen. Ja pra përse edhe Shqipëria dhe bankat të cilat operojnë në të, duhet t'i kushtojnë sadopak vëmendje provave të Bankës Qendrore Europiane.

FINANCIMI I NDËRMJETËM – NJË MUNDËSI PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË QEVERISË NDAJ BIZNESIT



Z. Altin HOTI, PHD
Dekan i Fakultetit Ekonomik,
Universiteti "LUARASI"



Dr. Elvin MEKA
Zv. Dekan i Fakultetit
Ekonomik, Universiteti
European i Tiranës

Ky model aktualizon dhe monetizon me disa vite avancë detyrimin që qeveria u ka njohur formalisht bizneseve dhe firmat që kanë nevoja të ngutshme likuiditeti mund ta shesin tërësisht, ose një pjesë të tij te një bankë, me një vlerë me të ulët, duke mundësuar kështu injektimin e menjëhershëm të likuiditeteve të lira, për funksionimin normal të tyre, si dhe zgjerimin në projekte të reja biznesi.

Kriza e fundit financiare dhe ekonomike globale, ndër të tjera, ka dhënë dhe ndikimin e saj në ekonominë shqiptare, nëpërmjet krijimit të një zinxhiri detyrimesh të pashlyera, qeveritar e private, si dhe mungesë likuiditetesh në rritje, duke e futur funksionimin normal të saj në një qerthull tejet të ndërlikuar. Aktualisht, diskutimi më i shpeshtë lidhet me çështjen e detyrimeve të papaguara të qeverisë ndaj ndaj bizneseve vendase, e kjo jo pa shkak, pasi nga pikëpamja e logjikës ekonomike, ky lloj detyrimi ka një ndikim dhe efekt të dukshëm mbi rritjen ekonomike, sidomos në kuadër të një krize të thellë likuiditetesh.

Sigurisht, lëvizjet e fundit të qeverisë për sigurimin e një huaje shumëmilionëshe nga FMN dhe fillimi i disbursimit të saj ndaj bizneseve ndihmon jo vetëm në rikthimin e imazhit e qeverisë si një partner dhe klient serioz për biznesin, por dhe synon të ndihmojë dhe mbështesë, aq sa mundet, edhe zbutjen e problemit të huave me probleme, brenda sistemit bankar shqiptar. Gjithsesi, të gjithë janë të ndërgjegjshëm se ky detyrim ndaj biznesit nuk pritet të shlyhet brenda një viti kalendarik, në rastin më të mirë do të kërkojë disa vite, e ndoshta alternativa e

huamarrjes vetëm nga institucionet mbikombëtare mund të mos jetë domosdoshmërisht zgjidhja e vetme dhe më praktike, nisur nga nevojat aktuale për financim dhe injektim likuiditeti në ekonomi. Praktikisht,

l vetmi disavantazh i aktualizimit të kësaj pjese të detyrimit të qeverisë është rritja e treguesit të borxhit publik, tej atij aktual, por dalja nga shtrëngesa në të cilën ndodhet ekonomia do të bëhej e mundur vetëm nëse do të vihej në lëvizje sektori real i ekonomisë. Këtu përmirësimi i treguesve të punësimit dhe rritjes ekonomike prevalojnë mbi ndjeshmërinë ndaj borxhit, ndërkohë që, kjo alternativë do ta shpërndante peshën e shërbimit të tij në aktorë të tjerë ekonomikë, si dhe do nxiste zhvillimin e tregut financiar me një instrument shtesë dhe tërheqës për investim.

mund të konsiderohet edhe një alternativë tjetër, që në kushtet e sotme mund të ndihmojë në përmbushjen e njëkohshme të disa objektivave, nga grupe të ndryshme interesi. Konkretisht, bëhet fjalë për konsiderimin e *financimit të ndërmjetëm (bridge financing)*, si alternativë që ofron një zgjidhje sinergjike, nga pjesëmarrja e tre aktorëve, që kanë problematika të ndryshme, por të lidhura ngushtë mes njëra-tjetrës: *qeveria, shoqëritë (bizneset) private dhe bankat tregtare*. Përpara se të shpjegohet parimi i funksionimit të kësaj alternative, le të shohim se cilat janë problematikat e secilit aktor:

Qeveria ndodhet përballë një situatë, ku megjithë seriozitetin dhe vullnetin e mirë për të shlyer bizneset për punët publike të kryera, nuk ka fonde të lira për këtë qëllim. Nga ana tjetër, madhësia e deficitit buxhetor nuk është në nivelet më të ulta optimale, borxhi qeveritar ka kapërcyer tashmë nivelin e 72 % ndaj PBB-së dhe shërbimi i tij bëhet edhe më kompleks, kur ritmet dhe rritja ekonomike janë të ulëta. Këtyre i shtohen dhe një sërë kushtesh që FMN i ka vendosur tashmë për zbatim qeverisë shqiptare, për akordimin e huas mbi 330 milionë euro, në kuadër të programit 36-mujor të mbështetjes

Skema e
Shpërblimit
GËZO KUDO



JE KETU!

Gëzo Kudo, me çdo blerje!

Përfito ulje unike të çmimeve me Skemën e Shpërblimit "Gëzo Kudo" të Tirana Bank, në një rrjet të gjerë tregtarësh në të gjithë Shqipërinë. Vetëm duke përdorur një nga kartat e Tirana Bank!



Në: Hotele, Restorante, Qendra Tregtare, Elektronike dhe Elektroshtëpiake, Qendra Estetike, Agjensi Udhëtimi, Makina me Qera, Fitnes...

Për më tepër në lidhje me "Gëzo Kudo" vizitoni www.gezokudo.al

www.tiranabank.al

PIRAEUS BANK GROUP



buxhetore (EFF). Në këto kushte bëhet e vështirë që të adresohet me shpejtësi problemi i detyrimeve ndaj bizneseve vendase vetëm nga qeveria.

Shoqëritë (bizneset), që kanë kryer punët me karakter publik, kanë një detyrim të paarkëtuar nga qeveria, detyrim ky që është shndërruar teknikisht në një ngërç për mirëfunksionimin e tyre dhe rrjedhimisht, ose ka bllokuar përfundimin e punëve të nisura, ose i kanë tkurrur ato nga investimet e reja. Në të njëjtën kohë, detyrimet e këtyre shoqërive ndaj të tretëve kanë përcjellë në formë zinxhiri borxhin financiar drejt të gjithë operatorëve të tjerë ekonomikë, duke i paralizuar edhe ato firma, të cilat nuk kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me projektet e qeverisë. Gjithashtu, me një bilanc të përkeqësuar financiar, shoqëritë e kanë të vështirë t'i drejtohen individualisht bankave, për të financuar vijimësinë e veprimtarisë së tyre.

Bankat tregtare, pavarësisht nga mungesa e panoramës rozë, kanë gjendje të kënaqshme depozitash, të cilat në "kundërshtim" me ligjësinë e krizës financiare, kanë ardhur gjithnjë në rritje. Nga ana tjetër, niveli i ulët i huadhënies së re gjatë viteve të fundit, u ka lënë bankave fonde të lira, të cilat nuk po gjejnë rrugën efikase drejt financimit të ekonomisë reale, megjithë përpjekjet e vazhdueshme të Bankës së Shqipërisë për ta kapërcyer këtë hendek, nëpërmjet një politike monetare ultradinamike të uljes në rekorde historike të normës bazë të interesit.

Në këto rrethana, do të ishte tejet e dëshirueshme për të gjithë vënia në funksionim e një mekanizmi që mundëson përdorimin eficient të fondeve të lira bankare, si lubrifikues i shpejtë i ngërçit dhe shtrëngesës së likuiditetit mes biznesit privat, që përbën kontribuesin kryesor të sektorit real të ekonomisë shqiptare. **Financimi i ndërmjetëm** do të ishte varianti më i shpejtë, e ndoshta më efektiv, që do të lidhte garancinë shtetërore të borxhit, fondet e lira të bankave dhe nevojën e biznesit për to. Ky lloj financimi do të konsistonte në ristrukturimin e një pjese të këtij detyrimi të prapambetur në letra me vlerë, të tipit "**premtimpagesë**" (*promissory note*), të cilat mund të skontoreshin (bliheshin me një zbritje të caktuar) nga bankat tregtare. Natyrisht, këtu bëhet fjalë që bankat do të mund të konsideronin blerjen me një çmim më

FINANCIMI & HUAJA E NDËRMJETME



Huaja e ndërmjetme përfaqëson një financim afatshkurtër, që shpesh përdoret përkohësisht, me qëllim të sigurimit të likuiditeteve të nevojshme, derisa të gjendet një zgjidhje më afatgjatë, për sa i përket financimit të huamarrësit. Gjithashtu, financimi i ndërmjetëm është një metodë financimi, që përdoret me qëllim ruajtjen e likuiditetit, ndërkohë që në të ardhmen parashikohet një rrjedhë e pritshme dhe e logjikshme likuiditetesh. Financimi i ndërmjetëm mundëson që një subjekt të mos humbasë shanset për të arritur një marrëveshje, apo ujdi, thjesht për arsye të mungesës së përkohshme të likuiditeteve, në një moment të caktuar kohe. Për më tepër, ai ofron një qasje të lehtë dhe të shpejtë në financim, duke e shndërruar atë në një alternativë lehtësisht të përdorshme. Shpesh të referuara si hua me para' në dorë, ato ndryshojnë nga huat tradicionale, si më poshtë:

- Afati i maturimit. Huat tradicionale (ato për strehim dhe letrat me vlerë të borxhit afatgjatë) kanë prirje të jetë afatgjata, ndërkohë që huaja (financimi) i ndërmjetëm nuk zgjat më shumë se 2-3 vjet.
- Financim në shuma të mëdha. Financimi i ndërmjetëm u mundëson subjekteve që e përdorin atë, një huamarrje në shuma të mëdha, brenda një periudhe të shkurtër kohe. Ky lloj financimi sigurisht nuk është për gjithkënd, por ndihmon në kapërcimin e pengesave të ndryshme, që nuk do të mundësonin arritjen e një ujdje të caktuar, nëse do të ndiqej rruga e financimit tradicional.
- Amortizimi. Huat e ndërmjetme, gjatë gjithë kohëzgjatjes, paguajnë përgjithësisht vetëm interes dhe pak ose aspak nga kryegjaja. Konkretisht, e gjithë kryegjaja shlyhet vetëm në maturim. Përveç kësaj, në këto raste mund të përdoret dhe teknika e amortizimit negativ, ose e kuponit zero.
- Norma e interesit. Meqenëse huadhënësit e huave të ndërmjetme marrin përsipër rreziqe shtesë - përfshirë këtu dhe rrezikun e likuiditetit, atë të dështimit dhe aksesin e kufizuar në informacion – huat e ndërmjetme zakonisht kanë një nivel më të lartë interesi sesa huat e tjera të ngjashme me to.
- Fleksibiliteti i ekzekutimit. Kostot relativisht të larta për huat e ndërmjetme kompensohen pjesërisht nga shpejtësia në të cilën e ofrojnë huadhënësit këtë lloj huaje. Huat e ndërmjetme mund të jetë shumë me leverdi, për të siguruar një formë fleksibel financimi për periudha afatshkurtra, që mundëson financim të shpejtë e injektim të përkohshëm të likuiditetit. Huat e ndërmjetme i ofrojnë huamarrësit fleksibilitetin për të vepruar shpejt, duke përfutur kështu nga mundësitë që ofron tregu në periudhën afatgjatë.
- Shumëllojshmëri. Ekzistojnë dy lloje financimi të ndërmjetëm: i mbyllur - ku huadhënësi dhe huamarrësi përcaktojnë një datë të caktuar në të ardhmen për shlyerjen e shumës së huas, marrëveshje kjo që mbështetet në kontrata ligjore. Ky lloj financimi i ndërmjetëm u ofron siguri huadhënësve; ndërkohë në rastin e financimit të ndërmjetëm të hapur nuk përcaktohet ndonjë datë e ardhme për shlyerjen.



të ulët të detyrimit të qeverisë ndaj biznesit, por kjo në mënyrë individuale (pra secila firmë zgjedh vetë nëse do ta skontojë detyrimin e saj). Një alternativë e tillë do të vinte në eficiencë tepricat e fondeve të bankave, me një “ngarkesë” të vogël për biznesin, për shkak se, rreziku sovran do të ulte shumë koston e përdorimit të këtyre parave. Ky model aktualizon dhe monetizon (sipas parimit të vlerës në kohë të parasë) me disa vite avancë detyrimin që qeveria u ka njohur formalisht bizneseve, për punët publike të papaguara, por jo vetëm. Kështu, firmat që kanë nevojë të ngutshme likuiditeti mund ta shesin tërësisht, ose një pjesë të tij te një bankë, me një vlerë me të ulët, duke mundësuar kështu injektimin e menjëhershëm të likuiditeteve të lira, për funksionimin normal të saj, si dhe zgjerimin në projekte të reja biznesi. Ndërkohë, bankat do të mund të arkëtojnë vlerën e plotë të detyrimit nga qeveria, duke përfitur si kthim normën e skontos, në afatin e maturimit të kësaj prem-

timpagese. Ky model shkon në një linjë mendimi me atë të profesorit të nderuar Paul Krugman, se: *“dalja nga kriza e borxheve mund të vijë vetëm duke marrë borxh”*.

Megjithëse për bankat tregtare ky lloj financimi mund të konsiderohet si hua jocalësore, rreziku i shlyerjes së saj është shumë minimal, pasi këtu garant dhe paguesja e vetme në maturim është qeveria, e cila në momentet aktuale, e më tej, mbështetet dhe nga institucionet mbikombëtare si: FMN dhe Banka Botërore, që i shërbejnë praktikisht financave publike shqiptare si një mbështetje plotëse, apo rritëse të besueshmërisë. Mendojmë se nga ky këndvështrim, i vetmi disavantazh do të konsiderohej fakti se, aktualizimi i kësaj pjese të detyrimit të qeverisë do të rriste treguesin e borxhit publik, tej atij aktual, por dalja nga shtrëngesa në të cilën ndodhet ekonomia do të bëhej e mundur vetëm nëse do të vihej në lëvizje sektori real i ekonomisë. Përmirësimi i treguesve të papunësisë

Financimi i ndërmjetëm (bridge financing), është një alternativë që ofron një zgjidhje sinergjike, nga pjesëmarrja e tre aktorëve që kanë problematika të ndryshme, por të lidhura ngushtë mes njëra-tjetrës: qeveria, shoqëritë (bizneset) private dhe bankat tregtare.

dhe rritjes ekonomike prevalojnë mbi ndjeshmërinë ndaj borxhit, ndërkohë që, kjo mënyrë e zgjidhjes së problemit të detyrimeve qeveritare do ta shpërndante peshën e shërbimit të tij në aktorë të tjerë ekonomikë, si dhe do nxiste zhvillimin e tregut financiar me një instrument shtesë dhe tërheqës për investim.

KONTRIBUTET PËR PENSIONE PRIVATE – NJË (MOS)PËRJASHTIM TATIMOR!

Për t'i dhënë shtysë skemave alternative të pensioneve është e dobishme që sa më shpejt të gjejë zbatim pa kufizim parashikimi i ligjit aktual "Për fondet e pensionit vullnetar", për ofrimin e lehtësive fiskale për kontributet në fondet e pensioneve private, nëpërmjet ndërhyrjeve që janë të nevojshme të bëhen në ligjin e tatimit mbi të ardhurat, për ta harmonizuar me vullnetin e ligjvënësit të shprehur në ligjin për pensionet.

nga **Zj. Teuta BALETA**
Këshilltare



Z. Rinald GURI
Drejtor i Departamentit
të Kërkimeve, TI & Statistikës

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, AMF

Tregu i pensioneve private në Shqipëri është zhvilluar relativisht vonë dhe përbëhet aktualisht nga tre fonde pensioni private, që funksionojnë sipas parimit të kolonës së tretë, ndërsa kolona e dytë nuk është e zhvilluar. Këto fonde aktualisht kanë 7,888 anëtarë dhe totali i aktiveve neto të tyre, në fund të vitit 2013, arriti në 443 milionë lekë, me një rritje prej afro 56.6%, krahasuar me fundin e vitit 2012, ose 188% krahasuar me fundin e vitit 2011, vit në të cilin filloi veprimtaria e fondit të pensioneve, bazuar në ligjin përkatës¹.

Rëndësia që kanë fondet e pensionit në ekonominë dhe sektorin financiar të vendit mbetet ende e vogël. Në fund të vitit 2013 raporti i totalit të aktiveve të fondeve të pensioneve me madhësinë e ekonomisë (e matur me PBB-në) ishte 0.03% në Shqipëri, nga 0.01% që ishte në vitin 2011 dhe mjaft i ulët krahasuar me rreth 7%, që është treguesi mesatar për vendet e OECD-së, po për vitin 2011, si dhe me disa vende të rajonit (shih tabelën). Tregu i pensioneve private zë 0.6% të sektorit financiar në vend dhe pjesëmarrja në këto skema mbetet ende e papërfillshme, në raport me forcën gjithsej të punës, pra vetëm 0.7%.

Zhvillimi i skemave alternative të pensioneve varet nga zgjedhja që

Vendi	Totali aktiveve / PBB (%)	Numri i anëtarëve
Shqipëria	0.03	7,888
Serbia	0.34	180,669
Maqedonia	0.08	18,665
Bullgaria	0.85	557,000

bëjnë individët për të kursyer dhe nga masa e kontributeve të tyre si anëtarë, apo pjesëmarrës në plane pensioni. Një nga praktikat e përdorura më gjerësisht, për të nxitur kursimin dhe për të rritur kontributin për pensionet, janë nxitësit fiskalë që ofron qeveria. Këta nxitës ofrohen në dy forma dhe përdoren veçmas ose të kombinuar. Nxitja fiskale ofrohet si lehtësim tatimor (ulje e shumës së tatimeve për t'u paguar), pra si njohje e kontributeve të pensioneve si shpenzime të zbritshme për qëllime tatimore. Gjithashtu, ajo ofrohet edhe si subvencion për individin kontribues.

Ligji i miratuar në vitin 2009² në Shqipëri parashikoi për herë të parë lehtësira fiskale, vetëm në formën e lehtësimit tatimor. Ligji për pensionet përcakton se kontributet e bëra nga çdo anëtar fondi pensioni, për

efekt tatimi zbriten nga të ardhurat personale të tij, e po ashtu edhe kontributet e punëdhënësit në favor të punëmarrësve të tij nuk vlerësohen si të ardhura personale të anëtarit (neni 88). Pra, një person që kontribuon në fond pensioni privat duhet të paguajë më pak tatim mbi të ardhurat personale, krahasuar me një person që nuk e bën këtë kontribut, për të njëjtin nivel të ardhurash bruto. Lehtësimi tatimor që njihet e përshkallëzohet sipas moshës së anëtarit ka një kufi maksimal vjetor përfitimi. Gjithashtu, kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve në një plan pensioni profesional njihen si shpenzim operacional i zbritshëm, deri në kufirin e 250 mijë lekë në vit (neni 89). Ndërkohë, ligji parashikon që pagesa e marrë nga anëtar i fondit të pensionit, të tatohet. Pra, ligji për

¹ Krijimi, funksionimi, rregullimi dhe mbikëqyrja e tregut të pensioneve private bazohet në ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar".

² Ligji nr. 10 197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar".

Procedurat tatimore përkatëse nuk parashikojnë që zbritja për qëllime tatimore të kryhet drejtpërdrejt nga punëdhënësi, sikurse ndodh gjerësisht në praktikën e vendeve që ofrojnë nxitje dhe lehtësi të tilla. Sipas legjislacionit në fuqi, pjesa e zbritshme e tatimeve rimbursohet, pasi më parë të depozitohet deklarata individuale tatimore.



pensionet ka parashikuar trajtimin e kontributeve në fondet private të pensioneve sipas parimit EET³.

Aktualisht nuk mund të vlerësohet se sa efektive është kjo skemë lehtësish fiskale, për arsye se në praktikë ajo nuk ka gjetur zbatim. Pavarësisht se sot ka mbi 7 mijë anëtarë të fondeve private të pensioneve, ata nuk përfitojnë nga lehtësia fiskale që ofron ky ligj. Kjo ndodh sepse sipas legjislacionit tatimor, në kuadër të tatimit mbi të ardhurat personale, kontributet për pensionin vullnetar njihen si shpenzime të zbritshme vetëm për ata kontribues të ardhurat vjetore bruto të të cilëve janë poshtë kufirit prej 1,000,050 lekë (neni 13/3)⁴. Gjithashtu, procedurat tatimore përkatëse nuk parashikojnë që zbritja për qëllime tatimore të kryhet drejtpërdrejt nga punëdhënësi, sikurse ndodh gjerësisht në praktikën e vendeve që ofrojnë nxitje dhe lehtësi të tilla. Sipas legjislacionit në fuqi, pjesa e zbritshme e tatimeve rimbursohet, pasi më parë të depozitohet deklarata individuale tatimore (nenet 10 dhe 13). Kjo ka bërë që nxitja fiskale në realitet të mos përfitohet për shkak: (1) të mosharmonizimit të legjislacionit; (2) se tatimpaguesi me të ardhura tatimore nën 1,000,050 lekë, duke mos qenë i detyruar të paraqesë deklaratë tatimore nuk është mjaftueshmërisht i informuar

për këtë përfitim. Duke patur parasysh që në praktikën juridike (hierarkia e akteve) përparësi në zbatim ka norma specifike, edhe në zbatimin e lehtësive fiskale përparësi marrin parashikimet e ligjit për tatimin mbi të ardhurat dhe akteve nënligjore përkatëse.

Një situatë e tillë ka cenuar interesat e shumë individëve që janë ose synojnë të jenë anëtarë të skemave të pensionit vullnetar. Aktualisht, investimi në fondin e pensionit vullnetar është alternativa më inferiore e investimit apo e kursimit, sepse nga parimi EET, i parashikuar në ligjin për pensionet, në fakt zbatohet si TET⁵, sipas parashikimeve të ligjit të tatimit mbi të ardhurat. Zhvillimi i kolonës së tretë dhe asaj të dytë, që të jetë efektiv, ka nevojë të mbështetet me trajtim fiskal të favorshëm, faktor ky që është i njohur dhe i pranuar pothuaj nga çdo vend që kërkon t'i zhvillojë këto skema. Sistemi duhet të funksionojë sipas parimit EET, ETT ose EEE⁶, që nënkuptojnë tri elementët: kontributet nga punëdhënësi dhe punëmarrësi, të ardhurat nga investimet ose përfitimet kapitale, si dhe pagesat në momentin e përfitimit. Këto elemente, sipas parimit të zgjedhur, përjashtohen nga tatimi (E) ose jo (T). Pothuaj të gjitha shtetet anëtare të BE-së i tatonë pensionet profesionale sipas parimit EET apo ETT, me synimin kryesor që të nxiten

qytetarët e këtij bashkimi të kursejnë. Pra, në mënyrë të qartë, Shqipëria ka një praktikë tatimore që nuk është në harmoni me praktikën e vendeve të BE-së, madje edhe të vendeve të rajonit, si Maqedonia, dhe nuk nxit rritjen e shkallës së kursimit afatgjatë.

Për t'i dhënë shtysë skemave alternative të pensioneve është e dobishme që sa më shpejt të gjejë zbatim pa kufizim parashikimi i ligjit aktual "Për fondet e pensionit vullnetar", për ofrimin e lehtësive fiskale për kontributet në fondet e pensioneve private, nëpërmjet ndërhyrjeve që janë të nevojshme të bëhen në ligjin e tatimit mbi të ardhurat, për ta harmonizuar me vullnetin e ligjëvënësit të shprehur në ligjin për pensionet. Kjo do të shërbente si një impuls afatshkurtër për zhvillimin e skemave të pensioneve në kolonën e tretë. Ndërkohë, reformimi afatgjatë i sistemit të pensioneve në lidhje me skemat e nxitjes fiskale kërkon harmonizimin legjislacionit dhe të praktikës me ato që ofrojnë vendet e BE-së. Zgjidhja për këtë çështje vlerësojmë se do të mund të kryhet shpejt, pasi ky hap favorizohet nga nevoja për zhvillimin e tregut të pensioneve private në vend, si pjesë e realizimit të reformës së sistemit të pensioneve. Një element i tillë është rekomanduar shprehimisht nga misioni FSAP dhe është në diskutim me autoritetet përkatëse.

3 EET shkurtim i termave exemption-exemption-taxation (përfashtim - përfashtim - tatim).

4 Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

5 TET shkurtim i termave taxation-taxation-taxation (tatim - përfashtim-tatim).

6 ETT dhe EEE shkurtim i termave exemption- taxation-taxation (përfashtim-tatim-tatim) dhe exemption-exemption-exemption (përfashtim- përfashtim-përfashtim).

ABENOMICS SI “POLITIKA E TRE SHIGJETAVE” - DEBATE DHE DYSHIME PËR EFICENCËN E SAJ



nga Prof. Dr. Adrian CIVICI
President & Drejtor
i Shkollës Doktorale
Universiteti Europian i Tiranës, UET

Që prej krizës së viti 1997 ekonomia dhe financat e Japonisë u gjendën në një situatë preokupuese: rritje ekonomike e ulët në nivelet 0-1%, deflacion dhe inflacion negativ, borxh i jashtëm në përmasa të jashtëzakonshme ose një rekord botëror, duke arritur në 240% të PBB-së, ekonomi në stanjacion, eksporte të lëkundura dhe gjithnjë e më pak konkurrese, të shoqëruara me një bilanc tregtar problematik, sidomos po të kihet parasysh roli i eksporteve në ekonominë dhe konsumin japonez, vështirësi gjithnjë e më të mëdha për të përballuar aktorët e rinj ekonomikë rajonalë si: Kina, Koreja e Jugut, etj.

Pas krizës financiare globale të vitit 2008, këto mund të ishin dhe janë shumë mirë dhe simptomat e shumicës së vendeve të zhvilluara, apo në zhvillim. Në dhjetor të vitit 2012, kryeministri i sapozgjedhur japonez, z. Shinzo Abe, duke ju referuar politikave neoliberalë të presidentit amerikan të viteve '80, z. Ronald Reagan dhe platformës së tij “Reaganomics”, shpalli ambicien për një politikë të re

Nga një këndvështrim më teorik, të tre shigjetat e Abenomics-it duket se i përgjigjen një situatë ekonomike e financiare specifike, në të cilën gjendet vendi, por duke ruajtur interpretimin e fenomeneve ekonomike sipas frymës së analizës neoklasike. Duket se shanset për sukses nuk janë të barabarta me shpresat dhe objektivat fillestare të kësaj pakete reformash.

“të ringjalljes ekonomike japoneze”, e cila u quajt “Abenomics” dhe u perceptua gjithashtu edhe si “politika e shansit të fundit”. Por, megjithëse këto dy lloj politikash janë pothuajse të kundërta përsa i përket qëllimeve dhe mjeteve që përdorin, ato afrohen në një pikë: nevojën për të braktisur politikat e vjetra ekzistuese dhe vendosmërinë për të luftuar kundër një problemi të identifikuar qartë. *Abenomics*-i u perceptua si imazhi i “tre shigjetave”, secila prej të cilave me destinacion “goditjen” e një objektiwi specifik: politikë monetare lehtësuese, duke shtuar masën monetare në qarkullim, politikë fiskale aktive dhe rilancim i investimeve publike e reforma strukturore, që synonin rritjen

Abenomics-i është përshëndetur “modestisht” nga tregjet financiare, ndërkohë që FMN është skeptike për rezultatet e tij, pasi Abenomics-i rrezikon të provokojë një rritje brutale të përqindjeve të interesit, duke e bërë problematike financimin e borxheve publike dhe rrezikuar falimentime bankare të rrezikshme.

e eksporteve, privatizime të rëndësishme dhe liberalizimin e tregut të punës. Qëllimi final duhej të ishte “dalja nga situata deflacioniste dhe rritjes ekonomike”. Shqetësimet, instrumentet dhe objektivat e saj përputheshin drejtpërdrejt apo tërthorazi me shqetësimet e gjithë vendeve të zhvilluara të botës, me preokupimet e mjaft institucioneve ndërkombëtare e financiare si: FMN, Banka Botërore, OECD, BE, BQE, FED, etj. A ishte “politika e tre shigjetave” një recetë që duhej rekomanduar dhe përdorur masivisht, apo ajo ishte një “specifikë japoneze”, me rezultate të paqarta? Tashmë thuajse 16 muaj pas fillimit të saj, analizat dhe debatet për eficientësinë e saj po marrin formë dhe po përpiqen të dalin në disa konkluzione konkrete.

“Shigjeta e parë” konsistonte në zbatimin e një politike monetare ekspansioniste, duke hedhur një masë shumë të madhe likuiditeti në ekonomi, me synim krijimin e inflacionit, rritjen e konsumit, zhvlerësimin e jenit, stimulimin e eksporteve dhe rritjen e produktivitetit ekonomik. Në praktikë, kjo nënkuptonte që, Banka Qëndrore e Japonisë, përveç fiksimit të një objektiwi prej 2% për inflacionin, duhej të blinte masivisht bono thesari të qeverisë japoneze, duke financuar kështu drejtpërdrejt shoqëritë dhe korporatat e vendit, por kundrejt rezikut të qartë të humbjes së pavarësisë së saj kundrejt

KREDI PËR **BIZNESE**

PËR NDËRMARRJE TË VOGLA DHE TË MESME

Kredi për Investime


Kredi për inventar dhe kapital qarkullues

Limiti kufi (Overdraft)

Limiti Kreditor

 **UNIONBANK**
Banka që dua

JAPONIA: Mekanizmi i “tre shigjetave” të Abenomics



pushtetit politik. Këtu bëhej fjalë për të dyfishuar masën monetare në qarkullim dhe synimi i kësaj mase ishte i dyfishtë: të stimulonte eksportet dhe të shtonte koston e importeve. Duke rritur koston e importeve, Japonia kërkonte të “importonte inflacionin nga jashtë”, duke shpresuar që ky inflacion do ndikonte në rritjen e çmimeve dhe pagave në vend. Rritja ekonomike dhe inflacioni do të ulnin automatikisht peshën e borxhit.

“Shigjeta e dytë” korrespondohte me një politikë buxhetore njaft aktive e stimuluese. Shteti dhe qeveria, me objektivin e mbështetjes së aktivitetit ekonomik, lançuan e financuan projekte të mëdha publike, në një vlerë që i kalonte të 110 miliardë USD në fushën e infrastrukturës, transporteve, aeroportëve, etj. Me këtë masë synohej të stimulohej prodhimi kombëtar, punësimi dhe konsumi. E kombinuar me një politikë monetare tejet ekspansioniste, kjo shigjetë duhej të godiste drejtpërdrejt inflacionin, duke e rritur atë, të stimulonte aktivitetin e korporatave kombëtare, si dhe të stabilizonte deficitet e tyre financiare.

“Shigjeta e tretë” kishte të bënte me reformat strukturore dhe synonte me përparësi zhvillimin e politikave liberalizuese dhe mbështetjen e atyre investimeve që dinamizonin prodhimin. Në paketën e masave të paraqitura dallonin reformat strukturore, që synonin hapjen akoma më të madhe ndaj tregtisë ndërkombëtare nëpërmjet marrëveshjeve të reja të tregtisë së lirë, rritjen e fleksibilitetit të tregut të punës, stimulimin e investimeve të huaja, duke ju krijuar atyre

kushte sa më tërheqëse e lehtësuese, rritjen e aftësisë konkurruese të disa prej sektorëve çelës të ekonomisë japoneze si: robotika, bioteknologjitë, bujqësia dhe industria agroushqimore, energjia, etj. Masat e shigjetës së tretë duhej të ishin thelbësore, në mbështetje të atyre të dy shigjetave të para.

Analiza për rezultatet dhe vlerat e *Abenomics*-it mund të bëhet në tre plane të ndryshme. Së pari, në rezultatet që kjo reformë prodhoi në këta 15-16 muaj të aplikimit të saj në Japoni, së dyti, në diskutimet dhe konkluzionet me karakter teorik e metodologjik që ajo prodhoi, e së treti, në mundësinë dhe hapësirat që një reformë apo koncepti i tillë të mund të zbatohet edhe nga vende të tjera, që kanë pak a shumë të njëjtat shqetësime e objektiva.

Si vlerësohet në Japoni rezultati i kësaj reforme? Politika voluntariste e Shinzo Abe prodhoi një zhvlerësim të fortë të monedhës kombëtare, jenit (26% në raport me euron dhe 20% në raport me dollarin amerikan). Me një jen të dobët, shoqëritë dhe korporatat japoneze eksportuese patën përfitime, pasi vëllimi i eksporteve u rrit me 9.3% gjatë vitit 2013, por ndërkohë, jeni i dobët pati një efekt negativ mbi importet, të cilat gjatë po kësaj periudhe u shtuan me 15%, duke e rënduar shumë sidomos faturën energjitike të vendit. Me ndalimin e punës në centralin atomik të Fukushima, tarifat e energjisë u rritën shumë, duke prodhuar zinxhir një rritje çmimesh të produkteve të konsumit të gjerë si: ushqime, veshje, etj. Sipas një sondazhi të realizuar nga agjensia e shtypit Kyodo, pavarësisht

nga disa rezultate të dukshme pozitive dhe shpresëdhënëse, 73% e japonezëve vlerësojnë se reforma *Abenomics* nuk ka ndikuar pozitivisht në situatën e tyre personale. Fuqia e tyre blerëse nuk ka ndryshuar. Duke patur parasysh se konsumi i brendshëm paraqet 50% të PBB-së së Japonisë, kuptohet qartë se kur fuqia blerëse bie, e gjithë ekonomia japoneze vuan dhe nuk siguron rritjen e saj të dëshiruar. Ndërkohë, rritja ekonomike dhe inflacioni që duhej të stimuloheshin maksimalisht nga paketa *Abenomics*, në fakt gjatë viti 2013 u rritën vetëm në masën 1.3-1.4%.

Dyshimet më të mëdha për eficientën e *Abenomics*-it qëndrojnë te rezultatet e shpresuara nga shigjeta e parë, sepse procesi i zhvlerësimit të monedhës duhet të plotësojë disa

Abenomics-i u perceptua si imazhi i “tre shigjetave”, secila prej të cilave me destinacion “goditjen” e një objektivi specifik: politikë monetare lehtësuese, duke shtuar masën monetare në qarkullim, politikë fiskale aktive dhe rilançim i investimeve publike e reforma strukturore, që synonin rritjen e eksporteve, privatizime të rëndësishme dhe liberalizimin e tregut të punës.



kushte të rëndësishme. Së pari, banka qendrore duhet të ketë kontroll të plotë mbi këtë operacion, e jo të jetë nën tryshninë e vendimeve politike, apo e kushtëzuar nga sjellja e tregjeve financiare. Së dyti, duhet që kërkesa e jashtme botërore të jetë shumë e fortë, për të përthithur shpejt dhe në masë të madhe eksportet “më të lira” japoneze. Por, konteksti i krizës globale dhe përpjekjet proteksioniste që evidentohen në mjaft vende të botës e vështirësojnë kontekstin e favorshëm të dëshiruar nga *Abenomics*-i. Së treti, banka qendrore që zbaton politikën monetare lehtësuese duhet të jetë sovranë dhe e vetme në zhvlerësimin e monedhës së saj, për të eliminuar konkurrencën, apo goditjet nga monedha të tjera. Në rastin e Japonisë, edhe pse ajo u bë vendi që zhvlerësoi më shumë monedhën e saj, edhe vendet e tjera bënë të njëjtën gjë, duke hyrë në një “luftë monedhash” të egër të filluar nga SHBA dhe vendet të tjera aziatike.

Nga një këndvështrim më teorik, të tre shigjetat e *Abenomics*-it duket se i përgjigjen një situatë ekonomike e financiare specifike, në të cilën gjendet vendi, por duke ruajtur interpretimin e fenomeneve ekonomike sipas frymës së analizës neoklasike, duket se shanset për sukses nuk janë të barabarta me shpresat dhe objektivat fillestare të kësaj pakete reformash. Bankat qendrore të shumë prej

vendeve të mëdha e të zhvilluara si: SHBA, Gjermani, Kinë, Angli, Kanada, Australi, Kore e Jugut, Brazil, Indi, Rusi, etj, janë të shqetësuara dhe ndjekin me kujdes efektet penalizuese që kjo politikë japoneze po shkakton, në mënyrë që të shmangin një rivlerësim të dukshëm të monedhave të tyre në raport me jenin japonez, në kontekstin e një ashpërsimi të luftës së monedhave, pasojat e së cilës do të ishin mjaft të rënda për ekonominë dhe financat botërore.

A mund të kopjohet apo të konsiderohet e vlefshme për vendet e tjera paketa e masave *Abenomics*? Duke u nisur nga elemente të veçanta të saj, sidomos gjendja ekonomiko-financiare që e detyroi Japoninë të merrte këto masa, si: rritja e ulët ekonomike, popullsi e plakur, borxh sovran i lartë, tensione deflacioniste, papunësi e lartë, etj, mund të thuhet se ajo ngjan jo pak me shumë vende europiane të tilla si: Spanja, Italia, Franca, Britania e Madhe, Portugalia, Greqia, etj, por dhe me vende të tjera të botës gjithashtu. Liderët europianë, në shumë raste e kanë përmendur “eksperiencën japoneze”, që nëpërmjet “lehtësimit buxhetor e monetar” synon një sukses aq të dëshiruar dhe në Europë, e për më tepër në një mënyrë të kundërt me “ortodoksinë monetare e buxhetore të mbrojtur me fanatizëm nga Gjermania”.

Abenomics-i është përshëndetur

“modestisht” nga tregjet financiare, ndërkohë që FMN është skeptike për rezultatet e tij, pasi *Abenomics*-i rrezikon të provokojë një rritje brutale të përqindjeve të interesit, duke e bërë problematike financimin e borxheve publike dhe rrezikuar falimentime bankare të rrezikshme. Në vendet perëndimore nënvizohet se leksioni më i madh që mund të nxirret nga masat me karakter ekstrem që përmban *Abenomics*-i, është shqetësimi që duhet të kenë vendet e zhvilluara për efektet e krizave dhe pasojat e keqmenaxhimit të tyre. Pas efekteve shkatërruese të fluskës spekulative financiare të viteve ‘80, kohë kur kapitalizimi i Bursës së Tokios ishte dukshëm shumë më i madh se Wall Street-i, apo kur Mitsubishi blinte “pa iu dridhur qerpiku” qëndrën Rockefeller, Japonisë ju deshën 24 vjet që të bëhej gati për një paketë reformash radikale, efekti i të cilave megjithatë nuk është i sigurtë. Ekspertët e ekonomisë dhe financave, evidentojnë efektet pozitive që po jep politika e Shinzo Abes, por vlerësojnë se do duhet akoma kohë për të bërë analiza të qendrueshme dhe nxjerrë konkluzione të besueshme për eficientë të *Abenomics*-it, sidomos kur bëhet fjalë për ta servirur atë si një recetë shpëtimtare për vende të tjera që kalojnë situata të vështira ekonomiko-financiare si Japonia.

ALPHA BANK - ALBANIA

Të ndjejmë botën përmes zërit

Alpha Bank – Shqipëri kontribuoi në mbrojtjen e bamirësisë: “Të ndjejmë botën përmes zërit”, e cila kishte për qëllim mbledhjen e kontributeve, për të mundur blerjen e programit për leximin e kompjuterit në shqip nëpërmjet audio-s, për personat me probleme shikimi në Shqipëri. Të pranishmit darkuan në errësi të plotë për rreth dy orë, e për të lehtësuar lëvizjen e tyre brenda mjedisit erdhën në ndihmë personat e verbër. Znj. Brunilda Isaj,

Anëtare e Drejtorisë Ekzekutive dhe Drejtore e Biznesit Bankar me Pakicë pranë Alpha Bank – Shqipëri u shpreh se solidarizimi dhe të kuptuarit e botës nga një tjetër kënd shoqërohet gjithmonë me ndjesi pozitive dhe dëshirë për të kontribuar në përfshirjen e plotë të personave me aftësi të kufizuar në jetën sociale dhe ekonomike.

Dita Botërore e Sindromës Down

Alpha Bank – Shqipëri ishte një nga sponsorët e konferencës: “Shëndeti dhe mirëqenia - Kujdes dhe barazi për të gjithë”, e organizuar në Ditën Botërore të Sindromës Down në 21 mars, nga Qendra Jonathan. Konferenca synoi në mbledhjen e fondeve për zhvillimin dhe mbështetjen e personave me sindromën Down në Shqipëri. Drejtori i Përgjithshëm i Alpha Bank – Shqipëri, z. Periklis Drougkas tha se të gjithë duhet të kontribuojmë, jo vetëm duke mbështetur financiarisht këto aktivitete, por dhe duke u siguruar individëve me sindromën Down një mjedis të drejtë, ku ata të ndihen të mirëpritur dhe të barabartë.



BKT

BKT mbjell 2,500 bimë dekorative në Bashkinë e Tiranës

Banka Kombëtare Tregtare, në kuadër të nismës për shtimin e hapësirave të gjelbra të Bashkisë së Tiranës, mbolli 2,500 bimë dekorative në rrugën “Dritan Hoxha” dhe Unazën e Re. Kjo veprimtari vjen si zbatim i politikës së përgjegjshmërisë sociale të BKT-së për mbrojtjen e mjedisit dhe rritjes së cilësisë së jetesës, në vendet ku ajo operon.

BKT dhuron një sondë ekografie për Maternitetin “Mbretëresha Geraldinë”

Në kuadër të politikës së saj të përgjegjshmërisë sociale, Banka Kombëtare Tregtare dhuroi një sondë ekografie për Maternitetin “Mbretëresha Geraldinë” në Tiranë.



CREDINS BANK

Credins Bank, si çdo vit, ka vijuar të japë kontributin e saj në fushën e artit dhe të kulturës. Gjatë kësaj periudhe përmenden:

- dhurimi i kostumeve të shfaqjes “Ballo e diplomës”, e vënë në skenë nga Teatri i Operas dhe Baletit, e para në llojin e saj, me koreografi të të mirënjohurit z. Ilir Kerni,
- botimet e librave të shkrimtarëve të njohur shqiptarë, si z. Nuri Dragoj, apo dhe ekspozita e skulpturave të të njohurit Profesor Ermir Grezda,
- sponsorizimi i spektaklit të organizuar nga Teatri i Kukullave Tiranë, për fëmijët me probleme shëndetësore dhe ata jetimë, duke shpërndarë gjithashtu edhe dhurata,
- mbështetja financiare e nismës së Shërbimit Kombëtar të Punësimit, për hapjen e zyrës së punësimit në qytetin e Vlorës, që do t’ju vijë në ndihmë të rinjve dhe forcës aktive të punës.



I CREDIT AGRICOLE

Banka Credit Agricole - Shqipëri mbështet projektin: "Të ndiejmë botën përmes zërit" Në kuadër të përgjegjshmërisë sociale, Banka Credit Agricole - Shqipëri mbështeti projektin që do të ndihmojë integrimin e personave me probleme shikimi në informacionin e pafund të botës së internetit. Projekti synon të përdorë zgjidhjen teknologjike text-to-speech, me qëllim

të përmirësojë kushtet e jetesës për rreth 20,000 persona me probleme shikimi. Nga ky aplikacion do të përfitojnë 5,000 persona të verbër të moshave të ndryshme, të cilët përdorin telefonat e tyre celularë me një aplikacion të ngjashëm. Projekti është një bashkëpunim unik midis Fondacionit Vodafone Shqipëri, Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë, si dhe bizneseve të tjera në vend.

I BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE

Stafi i bankës dhuron gjak

Për të tretin vit rradhazi, stafi i Bankës Ndërkombëtare Tregtare në Tiranë dhuroi gjak në ndihmë të fëmijëve talasemikë dhe personave që kanë nevojë për të, duke i'u përgjigjur apelit të Kryqit të Kuq Shqiptar. Kjo bankë do të vazhdojë traditën e dhurimeve vullnetare, 2 herë në vit.

Kontribut vullnetar për fëmijët jetimë

Në mbështetje të fushatës ndërgjegjësuere të mbledhjes së fondeve për fëmijët jetimë në komunitet, punonjësit e Bankës Ndërkombëtare Tregtare mbështetën Kryqin e Kuq Shqiptar dhe dhanë kontributin e tyre në vlerë monetare për këtë komunitet.

Riciklimi i letrave dhe mbetjeve plastike

Në kuadër të kujdesit ndaj mjedisit, Banka Ndërkombëtare Tregtare ka ndërmarrë një nismë të re, atë të riciklimit të letrave dhe mbetjeve plastike. Në bashkëpunim me "Green Recycling" dhe angazhimit të punonjësve të saj, banka tashmë riciklon të gjithë sasinë e letrave të përdorura dhe të mbetjeve plastike, duke kontribuar për një mjedis sa më të pastër.



I BANKA INTESA SANPAOLO – SHQIPËRI

Mblidh kapakë plastikë, ndihmo personat me nevoja të veçanta!

Intesa Sanpaolo Bank - Shqipëri është pjesë e kontribuesve në Projektin ACP (Albania Cap Project). Mbledhja e tapave plastike në 32 kutitë e shpërndara në të gjitha degët e saj, bëhet me qëllim krijimin e një linje zinxhir, ku nëpërmjet riciklimit të kapakëve plastike të mundësohet pajisja me karroca me rrota për personat në nevojë për to. Në këtë formë do të mund të kontribuohet në ndikimin e mbajtjes pastër të mjedisit si dhe pajisjen me karroca invalidësh, për personat të cilët nuk i kanë mundësitë financiare për t'i blerë ato.

"250 kg tapa/kapakë = 1 karrocë invalidi! Ndihmojmë personat në nevojë, ndërgjegjësohemi për riciklimin.

Festa e Karnavaleve për Fëmijë

Në 22 shkurt banka organizoi Festën e "Karnavaleve për Fëmijë", ku morën pjesë rreth 150 fëmijë të stafit nga e gjithë Shqipëria. Nën animacionin profesionist, fëmijëve iu dha mundësia të luajnë e argëtohen përgjatë 4 orëve, të veshur me kostume sipas personazheve të tyre të preferuar. Në fjalën përshëndetëse Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv z. Silvio Pedrazzi falenderoi prindërit dhe fëmijët për pjesëmarrjen.

MBLIDH KAPAKË, TAPA PLASTIKE
DHE NDIHMO PERSONAT
ME NEVOJA TË VEÇANTA!



“Ti japësh zë përfytyrimit të botës” - një sponsorizim që hap dyert e integritit

Banka mori pjesë në eventin special “Darkë në Errësi”, të organizuar nga Fondacioni Vodafone Albania, në mbështetje të personave të verbër dhe atyre me aftësi të kufizuara shikimi, të titulluar “Ti japësh zë përfytyrimit të botës”.

Dita e Verës - organizim për fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës

Banka sponsorizoi eventin e organizuar nga Shoqata “Martirë të Policisë së Shtetit”, në mjediset e TKOB, me rastin e Ditës së Verës, ku u mbledhën fëmijët jetimë të policëve të rënë në krye të detyrës dhe familjet e tyre.



BANKA NBG ALBANIA

Në mbrojtje të mjedisit

Stafi i NBG Bank - Shqipëri, organizoi një aksion vullnetar pastrimi në plazhin e Divjakës. Nisma u mbështet nga Bashkia Divjakë dhe kryetari i saj z. Fred Kokoneshi, i cili iu bashkua këtij aksioni. Zj. Aida Apostoli, Drejtore e Bankingut Individual, u shpreh se mbrojtja e mjedisit është një nga angazhimet e përhershme që Banka NBG Albania ka kundrejt komunitetit dhe ky aksion pastrimi është i pari mes disa të tjerëve në vazhdim.



PROCREDIT BANK

Në mbështetje të biznesit të vogël dhe të mesëm

ProCredit Bank, si një partner i qëndrueshëm dhe i besueshëm financiar për bizneset e vogla dhe të mesme, zhvilloi një sërë veprimtarish në qytetin e Durrësit, Korçës si dhe takime me bizneset lokale në qytetin e Fierit, për të diskutuar çështje të lidhura me paketën e re fiskale që ka hyrë në fuqi më 01 janar 2014 dhe ndikimin që ajo ka në biznes.



RAIFFEISEN BANK

Në mbështetje të atyre që nuk u tremben sfidave

Raiffeisen Bank sponsorizoi sfidën e radhës së ekipit të alpinistëve shqiptarë, pjestarë të shoqatës “Bjeshkatarë dhe Alpinistë - Tirana”. Në 11 shkurt, në orën 17.00, alpinistët ngjiten majën Aconcagua, maja më e lartë e Amerikës së Jugut me 6,962 m. Me gjithë vështirësitë, për shkak të kushteve atmosferike, i gjithë ekipi me të pestë alpinistët: Gjergj Bojaxhi, Fation Plaku, Ervin Dervishi, Gerti Pishtari dhe Erli Rrudho arritën të ngjiten dhe shpalosin flamurin e Shqipërisë në majën më të lartë të kontinentit amerikanojugor.



I SOCIETE GENERALE ALBANIA BANK

Kontribuon në organizimin e "Dites së Verës"

Tashmë "Dita e Verës" është një festë tradicionale, e cila festohet në mënyrë të veçantë në qytetin ku ka zanafillën e saj, në Elbasan. Me mbështetjen e Bankës Societe Generale - Shqipëri u shpërndanë 30,000 lule me urime në të gjithë qytetin si dhe u organizuan shumë veprimtari, si: parakalim me makina sportive në rrugën e Kalasë, koncerti i madh festiv dhe paradë me kostume shumëngjyrëshe.



I TIRANA BANK

Filozofia jonë: "Tirana Bank Përkujdeset"

Nën moton "Tirana Bank Përkujdeset", stafi i bankës theksoi pozicionimin e korporatës ndaj shoqërisë, duke ofruar ndihmën dhe mbështetjen në përmbushjen e objektivave të përgjegjësisë sociale të korporatës.

"Aktiviteti Lançues" - Menaxherët si Babagjyshë

Menaxherët Tirana Bank, të veshur si Babagjyshë, u dhuruan momente të lumtura fëmijëve me talasemi dhe leucemi, fëmijëve të policëve të rënë në detyrë dhe fëmijëve në nevojë, në veprimtarinë: "Orët e lumtura për fëmijët në nevojë". Ky gjest fisnik u bë i mundur nga katër anëtarë të Komitetit Ekzekutiv të Tirana Bank: z. Thalasinnos, z. Kousouris, z. Paloudis dhe z. Chaniotis. Kjo ishte një pasdite e bukur me lojra, muzikë, valle dhe natyrisht dhurata nga Babagjyshët.

Veprimtaria me Fondacionin Down Syndrome - Albania

Në vitin e ri 2014 Tirana Bank, në vend të shpërndarjes së dhuratave për klientët e saj, bëri një "dhuratë" më të madhe për ata që kanë nevojë më shumë: mbështeti dhe financoi Fondacionin "Down Syndrome - Albania". Fondacioni i dorëzoi një certifikatë falënderimi Tirana Bank për përfshirjen dhe bujarinë e saj.



I VENETO BANKA

Sponsor i projektit "Transformers"

Mbështeti projektin "Transformers" të piktorit Gjergji Meta, që u konkretizua me një ekspozitë të autorit në Muzeun Historik Kombëtar.

Shatërvan bashkëkohor në "Kombinat"

Veneto Banka, në kuadër të mbështetjes së projekteve të përgjegjshmërisë sociale, i dhuroi komunitetit të lagjes "Kombinat" në Tiranë një shatërvan, që ndodhet në qendër të kësaj zone. Kontributi i bankës u bazua në kërkesën e Minibashkisë "Kombinat" pranë bankës, për të mundësuar këtë projekt social.

Veneto Banka dhe Flamurtari

Veneto Banka, për të dytin vit radhazi, është sponsor i ekipit "Flamurtari" të Vlorës në Mini-Futboll, i cili kryeson aktualisht Kampionatin Shqiptar të Futbollit. Ekipet si: "Himara" në futboll dhe volejboll, "Besa" e Kavajës në futboll, "Marin Barleti" dhe "Besëlidhja" në volejboll për femra, kanë patur vazhdimisht mbështetjen e kësaj banke.



LAJME NDËRBALLKANIKE

BOSNJE - HERCEGOVINË

**Filialet RBI në Bosnjë - Hercegovinë përfitojnë nga investimet e IFC-së**

Balkans.com Business News Correspondent - 11.02.2014


IFC, anëtare e Grupit të Bankës Botërore, do të investojë deri në 150 milionë euro në Raiffeisen Bank International (RBI). Financimi do të kanalizohet drejt degëve të bankës në Europën Qendrore dhe Lindore, me qëllim rimëkëmbjen ekonomike dhe rritjen në rajon. Përfitues do të jenë filialet e RBI-së në Bosnjë - Hercegovinë, Poloni dhe Rusi.

EFSE jep hua për Komercijalna Banka AD, në Banja Luka

Balkans.com - 29.01.2014

Fondi European për Europën Juglindore (EFSE) akordoi një hua prej 3 milionë euro për Komercijalna Banka, me qëllim mbështetjen e zgjerimit të produkteve të huas për ndërmarrjet e vogla. Komercijalna Banka, degë e Komercijalna Banka AD Beograd në Serbi, ka në plan të zgjerojë biznesin, i cili aktualisht ka në fokus huadhënien për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

BULLGARIA

**Viti 2013, i vështirë për Bursën Bullgare të Aksioneve**

Dhoma Amerikane e Tregtisë, Bullgari - 13.01.2014

Sipas z.Vasil Simov, President i Bursës Bullgare të Aksioneve në Sofje, viti 2013 ishte një vit i vështirë. Biznesi dhe bursa u prekën nga trazirat politike në vend, theksoi z. Simov në konferencën për shtyp të raportit vjetor të shoqërisë.

Fibank merr miratimin për të blerë MKB Unionbank

Standart - 19.02.2014

Banka Qendrore e Bullgarisë i ka dhënë First Investment Bank (Fibank) dritën e gjelbër për të blerë rivalin më të vogël MKB Unionbank, raporton Reuters. Fibank është banka e tretë më e madhe e vendit nga madhësia e aktiveve dhe një nga bankat e pakta që nuk janë në pronësi të huaj. Gushtin e vitit të kaluar u theksua se ishte rënë dakord për të blerë MKB Unionbank nga Bayerische Landesbank e Gjermanisë (BayernLB). Megjithatë marrëveshja ishte subjekt i miratimit të bankës qendrore.

GREQIA

**Bankat greke janë në formën më të mirë ndër vite**

City Wire - 12.03.2014

Bankat greke gjenden në formën më të mirë që ato kanë patur ndër vite. Duke folur për Citywire Global, z.Francois Gobron, menaxher i Generali Investment theksoi se edhe pse Greqia është ende e zhytur në recesion, ka arsye për të qenë optimiste.

Alpha Bank Greqi në bisedime për të blerë një pjesë të Citibank

ekathimerini - 12.02.2014

Alpha Bank Greqi është në bisedime për të blerë një pjesë të operacioneve vendore bankare për individët të Citibank, njoftoi e përditshmja financiare Imerisia. Citibank, e cila filloi operacionet kredituese për bizneset në Greqi në vitin 1964, u zgjerua në bankingun për individë në vitet 80, dhe tashmë administron një rrjet prej 21 degësh në të gjithë vendin. Sipas gazetës, të dy bankat po hartojnë një plan, sipas të cilit Alpha Bank do të blejë divizionin e bankingut për individët dhe atë të menaxhimit të pasurisë së Citibank, pa cituar burimin apo ndonjë shifër lidhur me shumën që do të paguajë Alpha Bank për këtë marrëveshje.

•Kredi •Depozita •Biznes
•Transferta



KEMI FITUAR QETESINE ME



UBA

KOSOVA



Java Ndërkombëtare e Parasë

BQK - 14.03.2014

"Të mësojmë të kursejmë" ishte motoja e veprimtarisë që mbledhi në Bibliotekën Kombëtare, fëmijë, mësues të shkollave fillore të kryeqytetit, përfaqësues të Bankës Qendrore të Kosovës, Shoqatës së Bankave dhe përfaqësues të mediave. Në kuadër të edukimit financiar, me qëllim të ndërgjegjësimit të të rinjve në përgjithësi, çdo vit në gjithë botën organizohet fushata e njohur "Java Ndërkombëtare e Parasë". Bartëse të kësaj veprimtarie janë kryesisht bankat qendrore të vendeve përkatëse.

Banka Botërore mbështet projektet për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

BQK - 05.03.2014

Gubernatori i Bankës Qendrore të Kosovës z. Hamza u takua me zj. Ellen Goldstein, drejtoreshë e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor dhe z. Jan-Peter Olters, drejtor i zyrës së Bankës Botërore për Republikën e Kosovës. Gubernatori Hamza dhe zj. Goldstein shkëmbyen informacione mbi zhvillimet aktuale ekonomike e financiare në Kosovë, si dhe u diskutua për mbështetjen shumëdimensionale që Banka Botërore vazhdon të japë në zhvillimin ekonomik dhe institucional të Republikës së Kosovës.

KROACIA



Rreth 300,000 nënshtetasve kroatë u bllokohen llogaritë e tyre bankare

Balkans.com - 31.01.2014

Rreth 300.000 nënshtetasve kroatë u janë bllokuar llogaritë e tyre bankare për shkak të detyrimeve të pashlyera. Politikanët e opozitës kanë deklaruar në parlament se borxhi total i qytetarëve të sipërpërmendur është rreth 24 miliardë kuna kroatë. Këto shifra tregojnë gjithashtu nivelin e krizës ekonomike në vend, me një popullsi prej 4.2 milionë banorë dhe mbi 370,000 të papunë, siç raporton Croatian Times.

OTP Bank e Hungarisë blen Banco Popolare në Kroaci

bne - 03.02.2014

OTP njoftoi blerjen e degës kroatë të Banco Popolare, e cila zotëron rreth 0.6 përqind të tregut, me një kapital prej 324 milionë kuna kroatë (42.3 milionë euro). Kjo nënkupton se ajo është një marrëveshje e përmasave jo të mëdha.

MALI I ZI



BERZH-i do të japë hua për Societe Generale Bank - Montenegro

Balkans.com Business News Correspondent - 29.01.2014

BERZH do të japë një hua me vlerë 10 milionë euro për Societe Generale Bank të Malit të Zi, për financimin e huave afatgjata për strehim, për qytetarët në Malin e Zi. Fondet do të përdoren për kreditimin e popullsisë në një periudhë shtrëngese të huadhënies. Shefi i Zyrës së BERZH-it në Podgoricë, z. Gulo Moreno, tha se aktivitetet e reja të huadhënies në Mal të Zi ishin veçanërisht të rëndësishme gjatë rimëkëmbjes ekonomike, në mënyrë që vendi të kthehet në rrugën e rritjes së qëndrueshme dhe ekonomike.

Banka Intesa e interesuar të bashkëpunojë me Malin e Zi

Balkans.com Business News Correspondent - 03.02.2014

Ndihmësit e Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Malit të Zi, u takuan me përfaqësuesit e Intesa Sanpaolo Bank në Londër, dhe përfaqësues të Bankës së Zagrebit (pjesë e grupit të Bankës Intesa). Përfaqësuesit e bankës shprehën një qëndrim pozitiv ndaj veprimtarive të Ministrisë së Financave dhe diskutuan përparimin e Malit të Zi, në kuadër të përmirësimit të stabilitetit fiskal.

MAQEDONIA



Fitch e konfirmon vlerësimin "BB +" për Maqedoninë

Einnews.com 21.03.2014

Agjencia Fitch Ratings konfirmon për Maqedoninë, vlerësimin "BB+", me një parashikim "Të qëndrueshëm". Sipas Ministrisë së Financave, ky është një vlerësim i politikave ekonomike si dhe politikave në përgjithësi të ndërmarrja në vend. Borxhi i përgjithshëm i Maqedonisë pritet të pësojë një rritje modeste deri në rreth 36% në 2014 dhe 37% në 2015. Falë një stimuli të mëtejshëm nga investimet publike, Fitch parashikon që rritja do të përshpejtohet lehtësisht në vitin 2014 dhe 2015, respektivisht në 3.2% dhe 3.5%. Sektori bankar është i mirëkapitalizuar, me një madhësi të mjaftueshmërisë së kapitalit të Nivelit 1 (kapitali bazë) prej 14.4%, në fund të vitit 2013.

Vetëm 9 përqind e maqedonasve përdorin e-banking

Einnews.com 04.03.2014

Vetëm 9.1 përqind e përdoruesve të internetit në Maqedoni

përdorin shërbimet e-banking, sipas të dhënave të Zyrës Qendrore të Statistikave, raporton Kapital. Më shumë se 65 përqind e familjeve në vend kanë internet në shtëpitë e tyre. Bankierët thonë se shërbimet bankare elektronike janë rritur gjatë dy viteve të fundit, por Maqedonia ende mbetet pas vendeve më të zhvilluara dhe vendeve të tjera në rajon.

RUMANIA



Masat bankare shkaktojnë debate të ashpra në Rumani

Balkans.com Business News Correspondent - 14.02.2014


Synimi i qeverisë për të miratuar me urgjencë një ligj, që përcakton se kredimarrësit, të ardhurat e të cilëve nuk kalojnë 360 euro në muaj, sipas një marrëveshje me bankën do të paguajnë gjysmën e shumës së kësteve mujore të huave për një periudhë dy vjeçare, ka shkaktuar debate të ashpra në Bukuresht, raporton Radio Romania. Banka Qendrore ka deklaruar se nuk është ndërmarrë ndonjë politikë monetare në lidhje me riplanifikimin e pagesave të borxhit nga ana e njerëzve me të ardhura nën pagën mesatare neto. Banka ka thënë se ajo është konsultuar rreth projektit vetëm para dhe gjatë negociatave me autoriteteve FMN-së, Komisionit Europian dhe Bankës Botërore.

BEI mbështet ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Rumani

Balkans.com Business News Correspondent - 14.02.2014

BEI po jep një hua prej 15 milionë eurosh për BCR Leasing, për të financuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) dhe entet publike në Rumani, në zbatim të projekteve në industri, shërbime dhe infrastrukturë. BCR Leasing IFN SA, pjesë e Grupit BCR, që zotërohet nga Grupi Erste, po nënshkruan këstin e parë të huas prej 75 milionë eurosh, sipas marrëveshjes me BEI.

SERBIA



Sektori bankar serb i mirëkapitalizuar

Balkans.com Business News Correspondent - 20.02.2014

Serbia ka një sektor bankar të mirëkapitalizuar dhe të aftë për të siguruar të gjithë sektorin financiar, deklaroi


Guvernatorja e Bankës Kombëtare të Serbisë (NBS), zj. Jorgovanka Tabakovic. Bankat kanë aftësi të mira paguese dhe ekzistojnë mundësitë për rritjen e huadhënies, e cila aktualisht mungon, kryesisht për shkak të kërkesës së ulët për produktet e huas, tha zj. Tabakovic në një intervistë për të përditshmen e Beogradit "Vecernje Novosti".

Fondi Europian për Evropën Juglindore (EFSE) dhe ProCredit Bank - Serbia nënshkruajnë një marrëveshje të re huaje prej 15 milionë euro

Balkans.com Business News Correspondent - 12.02.2014

Fondi Europian për Evropën Juglindore (EFSE) dhe ProCredit Bank - Serbia nënshkruan një marrëveshje të re huaje prej 15 milionë eurosh, për financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në Serbi. Falë këtij objekti të huas, ProCredit Bank do të ofrojë financim afatgjatë që NVM-të serbe kërkojnë për investimet e tyre. Si pjesë e grupit ProCredit, ProCredit Bank - Serbia është e fokusuar fuqishëm në biznes dhe kreditimin e bujqësisë.

TURQIA



Pagesat e kësteve të kartave të kreditit bien me rreth 7 përqind

Balkans.com - 17.03.2014

Kufizimet në pagesat e kësteve për kartat e kreditit, të vendosura nga mbikëqyrësi bankar në Turqi kanë lënë gjurmët e tyre, sipas të dhënave të cilat tregojnë se vëllimi i kësteve ka rënë rreth 7 përqind në pesë javë. Agjencia e Mbikëqyrjes dhe Rregullimit Bankar (BDDK) ndërmori masa të reja, në fillim të shkurtit, për të frenuar përdorimin e kartave të kreditit për të paguar me këste mujore për mallra, me synimin e kufizimit të inflacionit në rritje në vend dhe të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Në Turqi ka rreth 57 milionë karta krediti - një për çdo turk në moshë pune.

Fitimet e sektorit bankar bien me 43.9 përqind

Balkans.com - 14.03.2014

Gjatë zhvillimit të punimeve të Forumit Bankar araboturk, të mbajtur në Stamboll më 13 mars, figura të shquara të sektorit synuan të minimizojnë shqetësimet pas zbulimit të të dhënave të fundit, të cilat tregojnë një rënie të fitimit neto të sektorit bankar turk në janar. "Siç kemi thënë më parë, disa masa të ndërmarrja nga drejtuesit ekonomikë u pritën të kishin një efekt negativ në fitimet e bankave. Megjithatë, ne nuk presim të shohim një rënie gjatë gjithë vitit", tha për gazetarët z. Hüseyin Aydın, Kreu i Shoqatës së Bankave Turke.



nga Zj. Najada XHAXHA

Kryetare e Grupit të Përdoruesve të SWIFT në Shqipëri

Drejtoresh e Departamentit të Pagesave, TIRANA BANK

Në vitin 1994 Shqipëria u rendit në listën e përdoruesve të SWIFT, duke u bërë kështu një nga shtetet e regjistruar dhe listuar përfundimisht në librat ndërkombëtare. I panjohur si fakt deri atëherë për Shqipërinë, të paktë ishin ata që kuptonin rëndësinë e pranisë në këtë komunitet ndërkombëtar. Shqipëria u bë shumë shpejt një treg i lakmuar për shtetet fqinje dhe bashkë me rritjen e marrëdhënieve tregtare me ta, edhe sistemi bankar mori një zhvillim të dukshëm. Ndikimi i këtij zhvillimi u shfaq së pari në formën e hapjes së tregut bankar, duke licencuar bankat e para private të huaja, e së dyti, në ndryshimin e mënyrës shumëvjeçare të ushtrimit të veprimtarisë bankare. Ndërkohë, ekzistenca si vend i listuar në SWIFT ishte një vlerë e shtuar për këtë treg të ri, si dhe një kërkesë e rëndësishme e biznesit dhe ecurisë strategjike të tij. Bankat në Shqipëri filluan të zbatonin standardet ndërkombëtare, kërkesë kjo e detyrueshme për zhvillimin e një biznesi të fortë. Tregtia me vendet fqinje, shtrirja e biznesit, lëvizja e popullsisë si dhe zhvillimet e vazhdueshme të teknologjisë, sollën natyrshëm nevojën për investime të bankave në sistemet e tyre të brendshme, me qëllim përshatjen e tyre me kërkesat e kohës.

Gjatë këtyre 20 viteve SWIFT-i u bë një nga bashkëdhëtarët në këtë

20 VJET SWIFT NË SHQIPËRI – 20 VJET PARTNERITET

Komuniteti bankar në Shqipëri është përdorues unik i platformës SWIFT, duke treguar një partneritet të konsoliduar dhe të qëndrueshëm, një biznes me përfitime të ndërsjellta dhe vlera të shtuara në vitet e përbashkëta të bashkëpunimit, të cilat duhet të konsiderohen, përforcohen dhe zgjerohen në të ardhmen.

rrugëtim të ndërsjelltë, duke u konsideruar dhe si teknologjia e fundit dhe jo vetëm. Në platformat e tij mbështeten thuajse të gjitha ndryshimet që solli monedha europiane. Sisteme të tilla si: RTGS (sistemi i shlyerjes së detyrimeve në kohë reale), TARGET (tërësia e sistemeve RTGS) dhe SEPA (një platformë pagesash vetëm për monedhën Euro) janë ndërtuar dhe bazuar në standardet dhe rregullat e SWIFT-it. Mbi platformën e tij është ndërtuar edhe infrastruktura e sistemeve të pagesave në Shqipëri.

Sistemi i Pagesave në Vlerë të Madhe (AIPS), që përdoret nga bankat në Shqipëri, bazohet në parimet e RTGS-së dhe sistemi i Pagesave me Vlerë të Vogël (AECH), gjithashtu bazohet në parimet dhe strukturat e sistemit SEPA, duke i hapur rrugë dhe dhënë mundësi zhvillimit të mëtejshëm të kërkesave kombëtare për një infrastrukturë të fortë dhe të qëndrueshme. Këtu duhet të

Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me strukturat përkatëse të bankave tregtare në Shqipëri, realizoi me sukses zbatimin e Standardeve të SEPA-s, duke zhvilluar me tej sistemin kombëtar të pagesave. Sistemi i ri filloi punën në 21 shkurt 2014 dhe ratifikimi i tij është në rrugën e duhur.

vlerësohet strategjia largpamëse e Bankës së Shqipërisë dhe mbështetjes profesionale të sistemit bankar në Shqipëri që sot, vendi ynë renditet së bashku me shumë shtete të zhvilluara në Europë, për një sistem pagesash të konsoliduar dhe bashkëkohor. Pikërisht kjo infrastrukturë e rëndësishme është ajo që do të mbështesë më tej zhvillime të tjera biznesi, duke sjellë në një platformë të përbashkët skemat kombëtare të debitimit të drejtpërdrejtë, të kalimit të pagave, të depozitorëve, kartave apo projekte të tjera, tashmë të lançuara në treg.

SWIFT dhe SEPA - Për një platformë të përbashkët

Janë pikërisht kërkesat e përdoruesve, banka apo biznese, që orientojnë SWIFT-in drejt vendosjes së prioriteteve, duke qenë kështu baza e zhvillimit të produkteve të tij. Njëkohësisht, strategjia e tij afatshkurtër dhe afatgjatë ka në përmbajtje mbështetjen e përdoruesve në projekte ndërkombëtare si: zbatimi me sukses i sistemit SEPA, zbatimi i legjislacionit dhe kuadrit rregullativ, shërbimet e përputhshmërisë, SWIFTRef dhe natyrisht, një qendër të vëmendjes janë gjithnjë siguria e lartë dhe besueshmëria në teknologji. Konkretisht, në tërësinë e produkteve dhe shërbimeve që SWIFT ofron, mund të identifikohet dhe vlerësohet ai që i përket edhe tregut shqiptar, si: SWIFT i përgatitur të ndihmojë të vonuarit në SEPA. Ndërsa afati i fundit i SEPA-s afrohet, pyetjet mbi gatishmërinë e industrisë mbeten. SEPA është një nismë me qëllim realizimin e pagesave elektronike në Euro brenda Europës, në mënyrë të thjeshtë, të lirë dhe me efikasitet, pavarësisht nga vendndodhja. SWIFT-i i ka mbajtur bankat të fokusuar te SEPA dhe

Prezenca gjeografike, Veneto Banka sh.a



DIREKTORIA E PËRQËTËSHMË:

Bhvd. "Dëshmoret e Kombit"
Kullat Binjake, Kati i Dytë
Tel. +355 (0) 42 280 555
Fax. +355 (0) 42 200 356
E-mail: info@venetobanka.al
www.venetobanka.al

TIRANA 1

Bhvd. "Dëshmoret e Kombit"
Kullat Binjake, Kati i Dytë
Tel. +355 (0) 42 280 555
Fax. +355 (0) 42 280 356

TIRANA 2

Bhvd. "Zogu I",
Stacioni i Trenit
Tel. +355 (0) 42 259 351
Fax. +355 (0) 42 259 350

TIRANA 3

Kashar - Mëzeq,
Autostrada Tiranë - Durrës, Km.3
Tel. +355 (0) 42 407 331
Fax. +355 (0) 42 407 330

TIRANA 5

"Rruga e Kavajës",
Poliklinikanca Italiane
Tel. +355 (0) 42 274 944/7
Fax. +355 (0) 42 228 636

TIRANA 6

Rr. "Sulejman Delvina",
Stadiumi "Dinamo"
Tel. +355 (0) 42 274 501/2
Fax. +355 (0) 42 203 555

TIRANA 7 (Kombinat)

Rruga e Kavajës,
përbashë Ministërishit Nr. 6,
Sheshi Qëndror i Kombinatit
Tel. +355 (0) 42 351 517
Fax. +355 (0) 42 350 978

ELIBASAN

Lgji. "Emin Matrëschiu"
Rr. "Kamber Sejfilni"
Tel. +355 (0) 54 242 245/6
Fax. +355 (0) 54 246 318

DURRËS 1

Qendra e Bënesit "EGT"
Sheshi pranë Bankësit
Tel. +355 (0) 52 229 331
Fax. +355 (0) 52 229 331

DURRËS 2 (Shkollor)

Lgji. 14, ish - NSI OMN-ja
Kompania "Pezja", Shkollor
Tel. +355 (0) 52 264 236
Fax. +355 (0) 52 264 249

VLORE

Bhvd. "Vlorë - Skelet",
të ish-Fabrikës e Orivit
Tel. +355 (0) 33 230 888
Fax. +355 (0) 33 230 888

FIER

Sheshi "Fitroja",
Rr. "Jakov Xoxa"
Tel. +355 (0) 34 231 876
Fax. +355 (0) 34 231 877

SHKODËR

Rruga "Studenti",
të Radio "Shkodra"
Tel. +355 (0) 22 250 288
Fax. +355 (0) 22 250 288

LEZHË

Lgji. "Bëstëlidhja",
Rr. "Hydajet Lezha"
Tel. +355 (0) 21 524 066
Fax. +355 (0) 21 524 062

KAVAJË

Lgji. "Nr. 1", "Murizi 2009"
Tel. +355 (0) 55 247 407
Fax. 0355 (0) 55 245 202

KORÇË

Bulevardi "Gjergj Kastrioti",
ish - Hotel "Turizmi"
Tel. +355 (0) 82 257 401
Fax. +355 (0) 82 257 861

Duhet të vlerësohet dhe strategjia largpamëse e Bankës së Shqipërisë dhe mbështetjes profesionale të sistemit bankar në Shqipëri që sot, vendi ynë renditet së bashku me shumë shtete të zhvilluara në Europë, për një sistem pagesash të konsoliduar dhe bashkëkohor.



vlerëson se ato duhet të jenë gati për afatin e fundit të zbatimit të tij. Nëse do të ketë vonesa, SWIFT-i do të ofrojë natyrshëm ndihmesë, për të siguruar migrimin e sistemit bankar. Ka patur shumë dyshime rreth realizimit të këtij projekti, por SWIFT ka një sërë produktesh e shërbimesh, që mundësojnë zgjidhje edhe kur ndonjë anëtar është i papërgatitur për afatin e fundit të SEPA-s (viti 2016). Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me strukturat përkatëse të bankave tregtare në Shqipëri, realizoi me sukses zbatimin e Standardeve të SEPA-s, duke zhvilluar me tej sistemin kombëtar të pagesave. Sistemi i ri filloi punën në 21 shkurt 2014 dhe ratifikimi i tij është në rrugën e duhur. Natyrisht që mbetet detyrë e komunitetit bankar shqiptar, që t'i shtojë vlera kësaj infrastrukture, duke rritur fushën e përdorimit, për një efikasitet të lartë dhe kosto të ulët”.

SWIFT, i hapur për biznes

Zgjedhja e mundësive të duhura është vendimtare për SWIFT-in dhe industrinë financiare. Qeveritë në mbarë botën kanë imponuar reforma të mëdha strukturore, me qëllim rritjen e transparencës dhe uljen e rrezikut që mbartin këto transaksione dhe procese, ndërkohë që kërkesat për kapital janë rritur. E gjithë kjo krijon sfida për të gjithë aktorët, veçanërisht bankat, të cilat operojnë dhe kryejnë transaksione globale. Në këtë mjedis të ri dhe dinamik, kërkesa të tjera rregullatore, të lidhura me përputhshmërinë dhe njohjen e klientëve rëndojnë mbi bankat. Kështu, bankat po investojnë sot dukshëm në infrastrukturë dhe burime njerëzo-

re, për të përmbushur kërkesat rregullatore, të lidhura me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Ndërkohë, në këto kushte, lind natyrshëm kërkesa për përballimin e sfidave që paraqesin këto kërkesa të shtuara, nëpërmjet përdorimit të një platforme të vetme. Kjo është një mundësi e mirë për komunitetin bankar shqiptar, për të konsideruar ndërtimin e një platforme kombëtare, duke krijuar skema në përputhje me legjislacionin, për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Një bashkëpunim i ngushtë midis strukturave përkatëse, do të ishte pikënisja drejt kësaj infrastrukture.

Siguria dhe besueshmëria - një sfidë e vazhdueshme për SWIFT-in

Duke qenë se trajton transaksione për mbi 10 mijë institucione dhe shoqëri financiare, 80% e investimeve të SWIFT-it shkon për rritjen e shërbimeve bazë dhe forcimin e infrastrukturës teknologjike. Rinovimi i platformës së mesazheve është nismë shumëvjeçare e SWIFT-it, për të rritur kapacitetin e përpunimit, fleksibilitetin dhe sigurinë, si dhe duke përmirësuar mbrojtjen e të dhënave. Infrastruktura e letrave me vlerë është një tjetër treg ku Shqipëria mund të mbështesë zhvillimet financiare. Sot, SWIFT-i është qendra e dërgimit/marrjes së mesazheve për shumë nga sistemet e pastrimit dhe shlyerjes të pagesave, letrave me vlerë, të këmbimit valutor dhe të derivateve. Infrastruktura e pastrimit dhe shlyerjes është një sistem që administrohet nga një organizatë publike (p.sh. një bankë qendrore), ose institucion

tjetër publik, një shoqatë apo subjekt privat, që ofron shërbimet e tregtimit, pastrimit dhe shlyerjes për industrinë financiare, duke realizuar përputhjen e transaksioneve financiare dhe funksionet depozituese. Një infrastrukturë e plotë e tregut përfshin një grup rregullash të biznesit, detyrimet, rregullat e pranimit, rregullat operative, rrjedhën dhe kanalet e komunikimit. Tregu shqiptar është aktualisht në fazën e përgatitjes së fillimit të projektit të zbatimit të kësaj infrastrukture. Projekti është njoftuar nga Banka e Shqipërisë dhe realizimi i tij pritet t'i japë një zhvillim të konsiderueshëm këtij biznesi në tregun shqiptar, duke shtuar vlerat e partneritetit me SWIFT-in.

Në zhvillimet aktuale të tregut, SWIFT-i është në pozicionin për të mbështetur dhe ndihmuar bankat me migrimin, përfshirë analizat e ndikimit të SEPA-s, konvertimin e numrave të llogarive bankare, integrimin, standardet, etj. Ai ofron gjithashtu FileAct, një shërbim që lejon siguri dhe besueshmëri në transferimin e skedarëve për mesazhet e pagesave, SEPA Plus dhe IBAN Plus, platforma që janë pjesë e shërbimit të të dhënave të referencës SWIFTRef- për “database”, si dhe trajnim në përdorimin e standardit ISO 20022. Komuniteti bankar në Shqipëri është përdorues unik i platformës SWIFT, duke treguar një partneritet të konsoliduar dhe të qëndrueshëm, një biznes me përfitime të ndërsjellta dhe vlera të shtuara në vitet e përleshkëta të bashkëpunimit, të cilat duhet të konsiderohen, përforcohen dhe zgjerohen në të ardhmen. Përfundimisht, kjo është thjesht çështje zgjedhjeje.

JAVA GLOBALE E PARASË (10-17 MARS 2014)

Java Globale e Parasë është një festë e përvitshme, e cila organizohet në mbarë globin nën koordinimin e organizatës “Child and Youth Finance International (CYFI)”. Gjatë kësaj jave, në mbarë botën organizohen veprimtari të ndryshme, të cilat kanë për qëllim të mësojnë fëmijët se si të kujdesen për paratë, përfshirë kursimin dhe të ardhurat.



Shoqata Shqiptare e Bankave u përfshi në këtë lëvizje globale, nëpërmjet organizimit të disa veprimtarive edukuese, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë. Të dy institucionet janë angazhuar në edukimin financiar të publikut nëpërmjet veprimtarive të shumta, publikimit të broshurave edukative, modulit me zgjedhje të lirë për nxënësit e shkollave të mesme: *“Financat personale në duart tuaja”*, si dhe paketës mësimore *“1, 2, 3 ... derrkuci Çufo mëson të kursejë”*.

Sipari i këtyre veprimtarive u hap me shfaqjen teatrore: *“Çufo dhe Tipi - Një aventurë me verdhushka”*. Kjo shfaqje u vendos në skenë në bashkëpunim me Teatrin e Kukullave. Gjatë ceremonisë së organizuar me këtë rast në Teatrin e Kukullave, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, nënshkroi një *Memorandum Bashkëpunimi* me Kryetarin e Shoqatës Shqiptare të Bankave, z. Seyhan Pencabligil. Qëllimi i këtij memorandum është nxitja e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, në fushën e edukimit financiar.

Nxënësit e 8 shkollave të ciklit të ulët në Tiranë ndoqën shfaqjen: *“Çufo dhe Tipi - Një aventurë me verdhushka”*, veprimtari e organizuar nga stafi i AAB-së dhe BSH-së. Banka Kombëtare Tregtare ishte sponsor i shfaqjeve gjatë javës dhe i dha mundësinë mbi 1,000 nxënësve të argëtohen me dy personazhe shumë të dashur për ta.



AAB, në vijim të angazhimit në fushën e edukimit financiar, organizoi më 17 mars orë të hapura me temë: *“Banka dhe Paraja”* në Universitetin Jopublik “Illyria” dhe në Shkollën Teknike Ekonomike në Tiranë. Leksionet u drejtuan nga zj. Najada Xhaxha, Drejtore e Departamentit të Pagesave në Tirana Bank.



Gjatë Javës Globale të Parasë dhe në kuadër të praktikës mësimore për lëndën: *“Financat personale në duart tuaja”*, nxënësve të shkollave të mesme iu dha mundësia të vizitojnë degë të bankave tregtare në Tiranë dhe në rrethe. Të gjitha bankat anëtare u treguan të gatshme për të bashkëpunuar në këtë projekt. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe Drejtorët e Përgjithshëm vizituan së bashku me nxënësit degët e Bankës Societe Generale në Tiranë, Credins Bank në Dibër dhe BKT në Lushnjë. Drejtorët e përgjithshëm të bankave respektive ishin gjithashtu të pranishëm gjatë këtyre vizitave.



Një tjetër veprimtari e organizuar në kuadër të Javës Globale të Parasë ishte dhe konkursi me Vizitime *“Paraja ime”*. Nxënësit e klasave të I-ra, II-ta dhe të III-ta të shkollave fillore u ftuan të realizonin vizitime mbi konceptin e tyre rreth parasë. Vizatimet u postuan në faqen edukative të Bankës së Shqipërisë në facebook. Dhjetë vizatimet që morën më tepër “pëlqime” në facebook u shpallën fitues të këtij konkursi. Në datë 31 mars u organizua ceremonia e ndarjes së çmimeve për fituesit, të cilët përfituan dhuratat simbolike si dhe depozita bankare me shumë fillestare 10,000 lekë, pranë Raiffeisen Bank.



